

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7558 E mërkurë 13 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion Ditës

**S**hç po shprehet, kuptohet dhe përjetohet gjithnjë e më qartë, ka ardhur një kohë kur edhe në demokracinë e reklamuar si kampione për liri ...  
Vijon në faqen 20

Nga XHEVAT MUSTAFA

**“Demokraci reale” apo “Diktaturë demokratike”?**



## Opinion Ditës

Nga ENKEL XHANGOLI

**T**ë dhunosh nuk është trimëri apo burrëri, por veçse një akt, i cili tregon karakterin e dobët të një mashkulli. Aq më shumë kur kjo dhunë ushtrohet ...  
Vijon në faqen 21

**Baba, mos vrit mamin, por mentalitetin dhe alkoolin!**



Projektvendimi/ Përfitojnë 665 mijë vetë

## Rama premtion rritje të pensioneve, ja kategoritë që marrin 2.8% shtesë në korrik

Administrata, më pak punonjës te Bujqësia. Herceptina hyn tek barnat e rimbursueshme


DARINA TANUSHI

665 mijë pensionistë do të kenë një rritje pensioni prej 2.8% duke filluar nga data 1 korrik. Kjo u vendos dje, në mbledhjen e qeverisë, e cila u zhvillua në Durrës. Kryeministri Edi Rama, gjatë konferencës për shtyp ...  
Në faqen 3

## DOSJET E VITEVE '99-2000, DOKUMENTET QE DUHEN PER TE MARRE PARATE

# KOMPENSIMI I PRONAVE, 30 DITE AFAT PER ANKIMIMET

ATP-ja publikon listën e re, 80% kompensim fizik dhe 20% financiar. Ish-pronarët që janë kundër vlerësimit përfundimtar mund të bëjnë padi në gjykatë



(Në foto) Qytetarë në sportelet e Agjencisë së Trajtitimit të Pronës

Në faqen 10

### NDERHYRJET NE RRUGE

**Tiranë-Durrës do bëhet me pagesë, për rehabilitimin u dhanë 615 mijë euro**

Në faqen 11

### DATAT PER NE KOMISION

**KEMP-i, emrat e 320 personave që duhet të kryejnë kontrollin mjekësor**

Në faqen 12

### EMRI I RI I FQINJEVE

**Shkupi dhe Athina bien dakord për “Maqedonia e Veriut”, heshtin shqiptarët**

Në faqen 2

### “VIP PAGES”

**Ish-banorja e “BB9”, Dona Pjetri: Dua që të testoj limitet e mia**

Suplement

### MARREVEESHJA



**Trump dhe Kim Jong-un takim historik, Meta dhe Basha: U tregua lidship**

Në faqen 17

Plaku i shtëpisë ku burri masakroi gruan: Më ndihmoni të rris vocërrakët

## “E bëra hasha djalin, ia 6 fëmijë jetimë”

Zaim Shaholli: Haja bukë e qepë që t'i jepja tim biri lekët e pensionit

Nga KLODIANA HAXHIAJ

**Q**ë prej pesë ditësh, në familjen Shaholli janë hapur dyert e mortit. Të afërmi, miq dhe të njohur hyjnë e dalin në shtëpinë njëkatëshe, e cila vetëm shtëpi nuk mund të quhet. Banesa është me soletë betoni, e pa



savatuar jashtë dhe brenda. Dritaret, në vend të xhamave kanë plasmas. Brenda skamja të vret sytë. Nuk ka frigorifer, vetëm ca kolltukë të vjetra të falura. Një televizor i vogël i kohës së diktaturës. Aty gjejmë prindërit e moshuar të 42-vjeçarit ...  
Në faqen 9

## 27-VJETORI I PS FESTIMET

### Kryeministri Zaev entuziast: Nuk ka më kthim mbrapa

## Shkupi dhe Athina bien dakord për emrin "Maqedonia e Veriut", heshtin shqiptarët


Maqedonia dhe Greqia janë pajtuar t'i japin fund çështjes së emrit të Maqedonisë, të kontestuar për më shumë se dy dekada. Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, tha se është arritur një marrëveshje historike që vendi të quhet Republika e Maqedonisë Veriore. Ai tha të martën se zgjidhja e kësaj çështjeje do t'i hapë dyert Maqedonisë për anëtarësim në NATO dhe në Bashkimin Evropian. "Nuk ka kthim prapa", tha



kryeministri Zaev në një konferencë shtypi pas një bisede telefonike me kryeministrin grek Alexis Tsipras. Kryeministri grek u shpre-

ji përmes një deklarate në televizion se marrëveshja do të sqarojë dallimin mes provincës greke të Maqedonisë dhe Republikës së

Maqedonisë Veriore. Më herët gjatë ditës është thënë se dy qeveritë kanë rënë dakord për përdorimin e termit "shtetas maqedonas" dhe "gjuhë maqedonase", ndërsa në pasaportë do të shkruhet "shtetas i Republikës së Maqedonisë Veriore". Po ashtu, Shkupi do të bëjë ndryshime në kushtetutën e vendit, duke e hequr referencën "për mbrojtjen e pakicave maqedonase jashtë kufijve të shtetit".



Mungesa në festën e Tiranës, kryeministri Rama shkon në Durrës, urimi i presidentit Meta për socialistët

# 27 vjet PS, Balla: Beteja jonë anëtarësimi në BE

## Mesazhi i Tahirrit: Do ringrihem! Herët, më shumë sesa vonë

Darina Tanushi

27-vjetori i themelimit të Partisë Socialiste është festuar në shumë qytete të vendit dje, duke mos i mbledhur drejtuesit në një vend këtë herë. Kështu kryeministri Edi Rama e festoi në mbrëmje bashkë me kabinetin qeveritar në qytetin e Durrësit, ku zhvilloi edhe mbledhjen e qeverisë. Ndërsa në Tiranë sekretari i përgjithshëm Taulant Balla e kryetarja e PS-së së Tiranës Blerina Gjylameti mbledhën disa nga figurat kryesore të kryeqytetit, në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar, ndërsa ra në sy mungesa e ish-kryetarit Saimir Tahiri, kreu të bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Nga figurat e vjetra socialiste morën pjesë Valentina Leskaj, Et'hem Ruka dhe Petro Koçi. Ndërsa për forcat politike të opozitës këtë përvjetor të PS-së nuk ka pasur ftesa dhe për rrjedhojë as nga PD, por as edhe nga LSI, nuk ka pasur asnjë përfaqësues. Kreu i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla tha në fjalën e tij 27



### ILIR META

Presidenti Ilir Meta uroi dje, 27-vjetorin e PS-së, si një prej ish-drejtuesit e saj të hershëm. Në një postim në "Facebook", ish-aleati i PS u shpreh: "Në këtë përvjetor të themelimit të Partisë Socialiste, kësaj force politike shumë të rëndësishme, kam kënaqësinë t'i uroj lidhshmëri, anëtarëve dhe simpatizantëve të saj, suksese në përmbushjen e përgjegjësisë qeverisëse në funksion të së ardhmes europiane të Shqipërisë".

vjet më parë socialistët shqiptarë nisën rrugëtimin drejt formësimit të një force progresiste europiane në Shqipëri. "Sot, 27 vite më vonë, Partia Socialiste është krenare që mbetet luftëtarja

kryesore për integrimin evropian të Shqipërisë", tha Balla. "Sot beteja jonë është: të shtrojmë rrugën finale drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke e bërë Shqipërinë pjesë reale të Eu-

### NIKO PELESHI

I pyetur për mungesën e Tahirrit në festë, ministri Peleshi tha: "Çdo socialist është patjetër pjesë e brendshme e kësaj partie. Saimiri është një kontributor i jashtëzakonshëm i PS-së, ka drejtuar PS-në e Tiranës që është zemra, bërthama e kësaj organizate të madhe. Do doja ta shihja këtu dhe ta falënderoja, ta përgëzoja për çfarë ka bërë".

### SALI BERISHA

Duke e cilësuar një falsifikim monstroz të historisë ndryshimin e emrit të PS-së nga Partia e Punës, Berisha tha dje, se deklarën me bindjen më të madhe se "nën udhëheqjen e Edi Ramës, PSSH është shndërruar në një fatkeqësi të vërtetë kombëtare, në parti de facto antieuropiane dhe antidemokratike".

ropës. Po përse duhet të jenë krenarë socialistët shqiptarë sot? Çdo socialist është krenar para qytetarëve shqiptarë, si kontribues i madh i modernizimit të Shqipërisë. Socialistët nxorën Shqipërinë nga batakuku e zhyti Sali Berisha në vitin 1997", tha Balla. "Socialistët janë krenarë për reformën e thellë të sistemit të drejtësisë, për standardin e demokracisë që i kanë dhënë këtij vendi, për betejat shembullore demokratike brenda nesh dhe me kundërshtarët, për civilizimin që shfaqim në debatet publike dhe mbi të gjitha, për shpresën që

mbajmë ende ndezur në këtë vend, të cilin një bandë mjernësh kërkojnë ta marrin peng për interesa të tyre"-u shpreh Balla. Ndërkaq vetë kryeministri Rama uroi 27 vjetorin herët në mëngjes përmes një vizatimi të bërë vetë, një fytyrë e qeshur "emoji", brenda së cilës ishte trendafilii i kuq. Kryebashkiaku i Tiranës Erion Veliaj shkroi në rrjetin social, Twitter PS nuk është veç një bashkim politik, por e vetmja forcë progresive që bën shtet, qytet, e Europë në Shqipëri.

### ISH-MINISTRI

Një urim i veçantë ka

ardhur nga ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri. Përmes një postimi në "Facebook", Tahiri shkroi dje: "Nga 27 vjet, kam jetuar pak më shumë se gjysmën e tyre mes shumë burrave e grave, të rinj e të reja në PS. Disa nuk jetojnë më, të tjerë jeta u ka hapur rrugë të reja, shumë janë ende e shumë bashkohen. Kam pasur privilegjin të njoh shumë prej tyre, të flas, të debatoj e mbi të gjitha të ndiej mbështetjen e shumë prej tyre në çdo moment. Akoma më shumë sot. Momente të vështira ka gjithmonë, jeta ma solli ta kuptoj shumë mirë këtë. Ka shumë të tjerë që kanë parë e shohin keq e më keq ama. E ndoshta as flasin dot. Por dikur, do ringrihem! Herët, më shumë sesa vonë. Për gjithçka duhet të bëjmë për të mos u përkulur para padrejtësisë. Për të dobët që do zë, të varfrin që do një shans, të mundurin që do drejtësi, të pastrehun që do shtëpi, të papunin që do punë, të aftin që do meritë, të gjithë janë Shqipërinë tonë, 27 vjet janë mjaftueshëm për të kuptuar qe do hedhim këmbën e radhës. Gëzuar!", mbyll urimin e tij, Tahiri.

REDAKSIONI: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delsula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autoktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123, Tiranë, Internet: www.gsh.al, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



Mbledhja e qeverisë dje në Durrës

Kategoritë që përfitojnë indeksimin në masën 2.8 përqind

# Vendimi i qeverisë, nga 1 korriku rritje pensionesh për 665 mijë vetë

Rama: Kemi vendosur 15 milionë plus në paketën e pensioneve

Darina Tanushi

665 mijë pensionistë do të kenë një rritje pensioni prej 2.8% duke filluar nga data 1 korrik. Kjo u vendos dje, në mbledhjen e qeverisë, e cila u zhvillua në Durrës. Kryeministri Edi Rama, gjatë konferencës për shtyp, në mjesditet e Muzeut Arkeologjik në Durrës tha se "... për 665 mijë pensionistë kemi rritur pensionet mbi inflacionin", "Nëse i referohemi shifrave, kemi vendosur 15 milionë dollarë plus në paketën e pensioneve me 2.8% rritje, duke nisur nga 1 korriku 2018", - tha Rama.

**VENDIMI**  
Sipas vendimit të qeverisë indeksim në masën 2.8 përqind, iu bëhet pensioneve të anëtarëve të kooperativave bujqësore, pensioneve sociale, shtesës mujore, të përfshirë me vendimin nr.326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar"; pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut"; shtesës mbi pension, të dhënë sipas nenit 33, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Nga ky vendim fitojnë edhe ish-ushtarakë, familjarët e ish-pilotëve që trajtohen me pension të veçantë; veteranë, etj. sipas vendimit, "Indeksimin, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.7.2018 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 30.6.2018, përfshirë edhe këtë datë", "Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij



Pensionistë

ligji, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr.150/2014, që kanë datë fillimi deri më 31.12.2014, pas datës 1.7.2018 nuk do të jenë më pak se 13 378 (trembëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë në muaj dhe më shumë se 26 757 (njëzet e

gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë në muaj", thuhet në vendim. Shuma bazë e pensionit, e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duke filluar nga data 1.7.2018 e në vazhdim të jetë 7 262 (shtatë mijë e dy-

qind e gjashtëdhjetë e dy) lekë. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përlogariten në shumën 1 545 000 000 (një miliard e pesëqind e dyzet e pesë milionë) lekë dhe përballohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e ISSH-së të vitit 2018, i cili ndahet: a) 1 532 000 000 (një miliard e pesëqind e tridhjetë e dy milionë) lekë, për mbulimin e pagesave të përfiti-me; b) 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare, sh.a.

**NAFTA**

Kryeministri Rama njoftoi se një tjetër vendim ishte aprovimi për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Bllokun 4 nga kompania e madhe globale "Shell", ku parashikohet një investim prej 42 milionë dollarësh. "Presim në vjeshtë konfirmimin dhe shpresojmë shumë në një konfirmim pozitiv të një zbulimi të madh, të një sasive të madhe nafte të lehtë dhe po ashtu gazi në vendin tonë", - tha Rama.



**Zv. kryeministria, në ministerialin e mirëqeverisjes**

Mesi: Administrata e depolitizuar, e ardhmja dhe sukcesi për vendin tonë

Ministrat përgjegjës për administratën publike dhe Financën, koordinatorët kombëtarë të Fondëve IPA nga Ballkani Perëndimor u mbledhën dje, në Bosnje, në ministerialin e Mirëqeverisjes në Ballkanin Perëndimor, organizuar nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike. Në cilësinë e udhëheqësit të Reformës në Administratën Publike për vendin tonë, e pranishëm në këtë ministerial ishte zv.kryeministria e Republikës së Shqipërisë znj. Senida Mesi e cila në referimin e saj në lidhje me reformën në administratën publike e konsideroi si një prej prioriteteve kyçe të qeverisë shqiptare për rrugëtimin e vendit drejt Bashkimit Europian (BE), nënvizoi faktin se kjo reformë e ndërmarrë përbën një angazhim të fortë ndaj qytetarëve, komunitetit të biznesit dhe partnerëve ndërkombëtarë, gjithashtu. "Besoj fuqishëm se një administratë publike e depolitizuar që ka në bazë dhe në thelb meritokracinë, do jetë e ardhmja dhe sukcesi për vendin tonë", -tha ajo. Mesi u ndal, gjithashtu, tek prioritizimi i reformave dhe zbatimi i planit ambicioz të qeverisë shqiptare në lidhje me reformën në shërbimet publike, procesi i derregullimit dhe ristrukturimi i agjencive dhe institucioneve të varësisë, si rezultat i të cilave është bërë goxha progres në drejtim të luftës ndaj korrupsionit dhe rritjes së eficientës në administratën publike.

**Barnat e rimbursueshme, shtohet lista me 40 medikamente, hyn herceptina falas**

Një tjetër vendim i rëndësishëm nga Durrës ishte edhe miratimi i listës për barnat e rimbursueshme. Kryeministri Edi Rama tha se një prej këtyre barnave është edhe herceptina, të cilën e marrin të sëmurët me kancer, të cilën pacientët do ta marrin falas. "Ky vendim vjen vetëm pak javë pas publikimit të listës së re të barnave të rimbursueshme, ku për herë të parë kemi përfshirë herceptinën, një ilaç të domosdoshëm për sëmundjet kardiovaskulare, neurodegeneruese, tumorale dhe të tjera. Një valë keqkuptimesh apo keqinformimi që u krijua në fillim tani po tretet, ndërkohë që do të rritet në mënyrë të ndjeshme përfitueshmëria e njerëzve në nevojë për mjekim", -informoi dje, Rama.



**Rishpërndahet numri i punonjësve, i hiqen Ministrisë së Bujqësisë, shkojnë te Mjedisi**

Këshilli i Ministrave miratoi dje, një rishpërndarje të numrit të punonjësve organikë të administratës qendrore. Në total, numri i punonjësve të institucioneve qendrore mbetet i njëjtë për vitin 2018. Sipas relacionit që shoqëron këtë vendim, në dikasterin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural numri i punonjësve pakësohet me 50 veta, nga ku 5 i përkasin aparatit të ministrisë, ndërsa 45 punonjësit e tjerë nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, duke e ulur numrin e përgjithshëm të institucionit në 1947 veta. Pesë nga këto vende do t'i shkojnë Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, duke e çuar numrin e punonjësve për këtë institucion në 28 veta. Ndërkohë, pjesa tjetër prej 45 vendesh i shtohen Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Pas këtij ndryshimi, numri i përgjithshëm i punonjësve organikë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit arrin në 1080 veta.

## NEGOCIATAT KUSHTET

Mesazhet e deputetit të Merkelit, kreu i PD-së: Qeveria, 'lakuriq' para botës

# Basha: Nëse e duam BE, Tahiri në burg dhe Xhafaj të largohet

## "Fasada ra, po pengohet integrimi"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, i bën thirrje kryeministrit Rama të heqë dy pengesat e mëdha që sipas tij mbajnë peng rrugëtimin evropian të Shqipërisë, të çojë në burg Saimir Tahirin dhe të largojë Fatmir Xhafajn nga Ministria e Brendshme. Duke cituar deklaratat e fundit të Johan David Wadehul, nënkryetarit i partisë së kancelares Merkel, z.Basha i bëri sërish thirrje kryeministrit Edi Rama që të largojë nga qeveria ministrin Fatmir Xhafaj dhe t'i japë fund mbrojtjes politike që po i bën Saimir Tahirit. "Kur na ndajmë vetëm 2 javë nga vendimi për hapjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në familjen europiane, mesazhet e Europës po bëhen çdo ditë e më të qarta. Hapja e negociatave dhe integrimi i Shqipërisë në BE nuk është proces reklamash dhe lobimesh personale. Është një proces i vërtetë i vepërimit dhe sjelljes si europiane. Strategjia e Edi Ramës përmes krijimit të një fasade të rremë që gjërat në Shqipëri shikojnë mirë, ka dështuar: Fasada ka rënë. Qeveria është lakuriq para botës. Sot nuk ecim më gënjeshtrat, mashtrimet, kërcënimet dhe fajësimet e të tjerëve", tha z.Basha. Nisur nga kjo, ai kërkoi: "Tahiri duhet të jetë aty ku e kanë vendin trafikantët. Nëse duam Evropën, Xhafaj duhet të largohet një orë e më parë. Qeveria duhet të luftojë e jo të mbrojë korrupsionin kriminelin e trafikun. Të bëjmë reformë zgjedhore e ndalim shitblerjen e zgjedhjeve. Rama, Tahiri, Xhafaj janë sot pengesat kryesore të integritimit në BE. Është e qartë se çfarë duan shqiptarët, hapjen e negociatave, ndaj është urgjente largimi i Xhafajt dhe dhënia fund e mbrojtjes politike që Rama po i bën Tahirit. Rama duhet t'i bindet vullnetit të shqiptarëve, ose duhet të largohet". Mesazhet e dy ditëve



Kryetari i opozitës Lulzim Basha

### SHKURT

#### Faktet, Tabaku: Në Shqipëri s'është rritur punësimi

Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku tregon 5 fakte pse në Shqipëri nuk është rritur punësimi, por propaganda qeveritare. "Fakt: 1.3 milionë shqiptarë kanë aplikuar për t'u larguar nga Shqipëria për në SHBA që nga shtatori 2013. Të dhënat flasin se për vitet e më shumë bashkëkombësit tanë aplikojnë të largohen nga vendi, duke u barazuar me vendet e Afrikës Qendrore dhe Ekuatoriale për nga numri i aplikantëve. Fakt: Janë mbi 300 mijë shqiptarë që janë larguar drejt vendeve anëtare të BE në forma nga më të ndryshmet. Këtë shifër na e kujton përditë Franca, Holanda dhe Gjermania, të cilat jo pak herë e kanë kritikuar dhe kërcënuar kryeministrin e tepsisë. Fakt: Shqipëria po shpopullohet dhe këtë e tregon përditë e më shumë edhe INSTAT, kur na fakton plakjen e vazhdueshme të popullsisë dhe se si rrezikojmë të shpopullohemi. Fakt: Janë vetëm 418 të punësuar në sektorin jobujqësor, ndërkohe që forca e punës, pra punëkërkuessit, janë në rënie. Tregues i qartë se Shqipëria po boshatiset nga shqiptarët, që po lënë çdo fshat e qytet për të ikur një orë e më parë nga sundimi i kësaj qeverie. Fakt: Rekordin e zi të shqiptarëve që largohen e dëshmojnë edhe të dhënat e tatimeve, që flasin për 3300 biznese që janë mbyllur vetëm për 2017. Numri i bizneseve të mbyllura është një rekord i zi historik, pasi është hera e parë në historikun e Shqipërisë demokratike, ku numri i bizneseve të mbyllura e tejkalon atë të bizneseve që hapen", shprehet Tabaku.

më parë të zv.kryetarit të Grupit Parlamentar CDU/CSU se Shqipëria nuk ka plotësuar asnjë kusht për hapjen e negociatave, se Tahiri është "peshk i madh" dhe Xhafaj duhet të largohet, sipas Bashës janë pasqyra e vërtetë e gjendjes në Shqipëri dhe prova se gënjeshtrat nuk ecin. "Zgjedhja që kemi sot përpara nesh është e qartë: nëse duam Evropën, Samir Tahiri duhet të jetë aty ku e kanë vendin

trafikantët dhe pushtetarët e lidhur me trafikantët. Është e qartë se çfarë duan shqiptarët, shqiptarët duan Evropën. Shqiptarët duan hapjen e negociatave, ndaj është urgjent largimi i Fatmir Xhafaj dhe dhënia fund e mbrojtjes politike që Rama po i bën Saimir Tahirit. Zgjedhja është e shqiptarëve dhe jo e Edi Ramës. Edi Rama duhet t'i bindet vullnetit të njerëzve, ose të largohet", theksoi kreu i PD-së.

### PETRIT VASILI

"400 mijë shqiptarë të ikur në vitet e fundit nga papunësia dhe varfëria, çfarë janë për këtë kryeministër? Turp dhe faj i rëndë të tallsh me varfërinë, ky e bën dhe kjo i jep kënaqësi. Papunësia është kthyer në tragjedinë e vërtetë të Shqipërisë. Kryeministri do vazhdojë të gënjejë, sepse atij si Shvejkut, nuk i duhet gjë se çfarë thotë vetë", tha z.Vasili.



Parlamenti Evropian

### ANTONIO CORBO

Eksperti i KiE, solli shembull mënyrën e funksionimit të ligjit në shtetit fqinj për të evituar shitblerjen e votës. "Kandidatët në Itali gjatë fushatës zgjedhore nuk mund ta kalojnë shumën 52 mijë euro për shpenzime elektorale, në rast të kundërt, atij i hiqet mandati. Gjithashtu, nëse një deputet fotografohet më një apo disa persona të inkriminuar, mund të dënohet deri në 6 vjet burg. Ndërrhyrja e mafies në zgjedhje është një problem mjaft shqetësues edhe në Itali", tha Antonio Corbo.



#### Përleshja me policinë, procedohen penalisht 25 protestues

Të rinjtë e FRPD dhe LRI protestuan sërish dje para Ministrisë së Brendshme, por për marshimin të Kryeministria dy ditë më parë, policia e Tiranës bëri dje me dije dje se janë proceduar penalisht 25 shtetas për "Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullime e manifestime të paligjshme", si dhe për "Prishje të rendit dhe qetësisë publike". Shtetasit, rreth orës 18:30, nga Ministria e Brendshme në drejtim të Kryeministrit kanë organizuar një tubim të paligjshëm dhe kanë vazhduar duke prishur rendin dhe qetësinë publike edhe pas lajmërimit të bërë nga ana e policisë për shpërndarje. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur për veprat penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në manifestime e grumbullime të paligjshme" dhe "Prishja e qetësisë publike", parashikuar nga nenet 262/1 e 274 të Kodit Penal.

#### Eksperti i KiE: Me legalizimet e banesave u blenë vota në 2017-ën

Ekspertët e KiE kanë konstatuar jo vetëm fenomenin e shitblerjes, por edhe mënyrat e blerjes së votës. Para, punësimet në administratë si dhe favoreve klienteliste të gjitha në këmbim të votës. Të gjitha këtu u diskutuan dje në një tryezë për shitblerjen e votës. Demokratët kërkuan që votimi elektronik të aplikohet në këto zgjedhje, ndërsa përfaqësuesit e majtë ofruan angazhim të të gjithë aktorëve kundër këtij fenomeni. Në një tryezë me Komisionin e posaçëm të Reformës Zgjedhore, eksperti Quentin Reed tha që sipas këtyre të dhënave janë gjetur edhe format si blidhet vota. "Shitblerja e votës është një krim që duhet ndëshkuar me ligj, por fillimisht duhet kuptuar pse votuesit e shesin votën e tyre. Nga studimet e bëra në Shqipëri, 20% të shqiptarëve u janë ofruar para për votën, ndërsa 5-6% janë detyruar të marrin pjesë në aktivitetet politike në vitin 2017. Shitblerja e votës realizohet në disa mënyra, në këmbim të parave, të mallrave, por edhe me anë të punësimeve në administratë. Gjithashtu, edhe kontratat e legalizimit të banesave janë përdorur për të blerë votat", deklaroi z. Quentin Reed. Bashkëkryetari e Komisionit për Reformën Zgjedhore, demokrati Oerd Bylykbashi shprehu angazhimin për ta evituar këtë fenomen dhe sipas demokratëve, një nga mënyrat është futja e votimit elektronik. "Shitblerja e votës është një problem i vjetër dhe thelbësor, por për t'i dhënë fund këtij fenomeni duhet të ketë vullnet politik. Një tjetër mënyrë për të reduktuar shitblerjen është votimi elektronik në zgjedhje. Gjithashtu, mosnëdhënia e këtij fenomeni i jep më shumë mundësi që të zgjerohet dhe të mos ndalet", tha z.Bylykbashi.

## TAKIMI MARREVESHJA



Dy liderët firmosën marrëveshjen për nisjen e procesit të denuklearizimit

# Trump dhe Kim Jong -un takim historik në Singapor

*Udhëheqës në mbarë Azinë janë shprehur optimistë për të ardhmen*

Gjatë ditës së djeshme në orët e para të mëngjesit u zhvillua takimi mes Donald Trump dhe liderit koreano-verior Kim Jong-un në ishullin e Sentosa-s, në Singapor. Dy liderët shtrënguan duart duke i dhënë fund armiqësisë prej gati 7 dekadash mes Shteteve të Bashkuara dhe Koresë së Veriut. Ky ishte një takim historik, pasi për herë të parë një president i Shteteve të Bashkuara takohet me një lider të Koresë së Veriut. Fillimisht, bisedimet u zhvilluan kokë më kokë me praninë vetëm të përkthyesve. Zyrtarët amerikanë kanë thënë se çdo marrëveshje që mund të arrihet duhet të ketë si rezultat dhënien fund të kërcënimit që përbëjnë armët bërthamore dhe raketat balistike të Koresë së Veriut. Pas takimit vetëm për vetëm, dy udhëheqësit hynë në një takim dy-palësh më të zgjeruar, me praninë edhe të Sekretarit të Shtetit Mike Pompeo, shefit të Personelit të Shtëpisë së Bardhë John Kelly dhe Këshilltarit për Sigurinë Kombëtare John Bolton. Pasi iu drejtuan fotografave e telekamerave, dy liderët u ulën në një sallon të hotelit luksoz Capella ku dhanë deklaratat për mediat dhe i pari foli Trump. "Është një nder i madh të gjendem sot këtu. Besoj se kjo nisimë ka për të qenë një sukses, do të ndërtojmë mes nesh një marrëdhënie të shkëlqyer", deklaroi Presidenti Trump. Ndërsa Kim u shpreh se: "Do të ketë sfida përpara, por ne do të punojmë me Trumpin. Kemi mposhtur të gjitha llojet e skepticizmit dhe spekulimeve për këtë samit dhe besoj se kjo është diçka e mirë për paqen. Ne tejkaluam me guxim



**REAGIMI I METES**  
"Përshëndes përfundimet e Samitit të Singaporit. Presidenti Trump tregoi lidhshëm, vendosmëri, mençuri e përgjegjësi të lartë globale duke treguar sërish se SHBA mbeten miqtë më të mirë, më të besuar dhe më të vendosur për paqen dhe stabilitetin në Botë. Krenarë për partneritetin me këtë vend të madh", shkruan Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta.



**REAGIMI I RODMAN**  
Ish-basketbollisti amerikan Dennis Rodman nuk ka mundur t'i ndalë lotët e gëzimit për takimin që ai e quan historik. "U kam thënë të gjithëve, se do të hapet dera. Por të gjithë më thoshin se një gjë e tillë është e pamundur. Kur u ktheva në shtëpi, filluan të më kërcënojnë me vdekje, por për asnjë moment nuk e kam ulur kokën, e dija që gjërat do të ndryshojnë", ka deklaruar Rodman.

të kaluarën, e cila na mban të mbrapa dhe u ulëm bashkë, mendoj se ky është një prelude i paqes. Ne do ta zgjidhim, do të jemi të suksesshëm dhe mezi pres që të punoj me ju. Do të bëhet." Liderët nënshkruan një deklaratë të përbashkët, ku pika më e rëndësishme është angazhimi i Koresë së Ver-

it për nisjen e procesit të denuklearizimit. Donald Trump ishte i vetmi që foli pas nënshkrimit dhe tha se takimet do të vijojnë në rang kryediplomatësh. Në shenjë miqësie në përfundim të takimit Trump i hapi Kimit, dyert e 'Mercedesit' të tij presidencial me vlerë 1.6 milionë dollarë, prodhuar

me porosi për t'i rezistuar sulmeve ushtarake e kimike. Për të ndjekur takimin historik, në Singapor ishin rreth 5,000 gazetarë, por vetëm një grup i vogël reporterësh amerikanë dhe koreano-veriorë u lejuan të ndjekin momentin kur të dy udhëheqësit përshëndetën njëri-tjetrin.

### REAGIMI I BASHËS



**Lulzim Basha  
përshëndet takimin  
Trump-Kim Jong-un**

Hapja e këtij procesi paqeje dhe çarmatimi në rajonin e një ndër konflikteve më të mëdha, të gjata e të përgjakura të globit përbën një sukses historik të jashtëzakonshëm të Presidentit të SHBA, Donald J. Trump. Në emër të Partisë Demokratike përshëndes SHBA dhe Presidentin Trump për këtë arritje të përmasave globale, me vlera themelore për zhvillimet ndërkombëtare botërore. Partia Demokratike dhe unë jemi krenarë dhe totalisht të përkushtuar në aleancën e vlerave Atlantike dhe partneritetin strategjik me SHBA nën lidhshërinë e Presidentit Trump, si partneritet jetik dhe i pazëvendësueshëm për ndërtimin e një bote më të sigurtë, në paqe, të lirë dhe demokratike.

Samiti hap një epokë të re pozitive për paqen dhe sigurinë globale. Dy liderët i japin fund veçanërisht tension-

eve që e çuan botën në prag të shpërthimit të konfliktit bërthamor që do të rrezikonte jetën e dhjetëra miliona njerëzve në gadishullin korean e më gjerë. Kina nxitoi ta përshëndeste samitin e rrallë, duke deklaruar se: "Fakti i thjeshtë që dy liderët arritën të ulen së bashku e të angazhohen në mënyrë të barabartë në bisedime është i rëndësishëm, pozitiv e çel një faqe te re ne histori". Ndërkohë takimi historik mes dy liderëve, Donald Trump dhe Kim Jong-un ka qenë lajmi kryesor edhe në Korenë e Veriut. Koreano-veriorët janë informuar hap pas hapi për gjithçka ndodhte në Singapor, përmes disa ekraneve gjigante të vendosur kudo në Penian, ku televizioni qendror i Koresë së Veriut transmetonte "live" takimin. Qytetarët ishin mbledhur në rrugët kryesore për të ndjekur "live" çfarë ndodhte, duke nisur nga lideri i tyre Kim Jong-un teksa zbrishte nga avioni. Televizioni shtetëror KCNA ka raportuar hap pas hapi detajet e takimit, përveç momentit të shtrëngimit historik të duarve mes dy liderëve. Sakaq udhëheqës në mbarë Azinë dhe nga vende të tjera janë shprehur me tone optimiste për të ardhmen, pas takimit historik mes Presidentit amerikan Donald Trump dhe udhëheqësit koreano-verior Kim Jong-un në Singapor.



## Vrasja e Marvi Mihalit për një karikues, kthehen në burg 2 bashkëpunëtorët

Gjykata e Tiranës ka ndryshuar ditën e djeshme masën e sigurisë për dy të rinjtë Marsel dhe Kridens Alla, të cilët akuzohen për vrasjen e 22-vjeçarit Marvi Mihali, për një karikues. Për dy të rinjtë me kërkesë të prokurorisë nga masa "detyrim paraqitje" u

vendos masa "arrest me burg". Ndërsa, për shtetasin tjetër bashkëpunëtor në vrasje, Eugen Bitraj, është lënë në fuqi masa e arrestit "detyrim paraqitje". Ndërkohë, hetimet për vrasjen e 22-vjeçarit janë mbyllur dhe dosja ka shkuar për gjykim. Pak kohë më parë, prokuro-

ria liroi nga burgju tre të rinjtë, duke lënë pas hekurave vetëm njërin prej autorëve të krimit, 19-vjeçarin Dejvi Bitraj. Marvi Mihali u vra më 31 korrik të vitit 2017 në zonën e stadiumit "Dinamo". Miku i tij Armend Haxhiu i kishte shitur një telefon Devi Bitrajt, por

nuk i kishte dhënë karikuesin. Pas debateve mes Haxhiut dhe Bitrajve është vendosur që të takohen për t'u sqaruar tek Dinamo. Haxhiu ka kërkuar që aty të shkonte edhe miku i tij Marvi Mihali dhe pas shumë telefonatash ka arritur ta bindë Marvin. Sapo ka mbërritur Mihali, Haxhiu ka goditur me grusht një prej të dyshuarve. Marvi ka ndërhyrë për t'i ndarë dhe aty është goditur me thikë nga Devi Bitraj.

Babai i 19-vjeçares: Tri ditë para se të ma vrisnin vajzën, policia tha se do ta mbronte

# Vrasja në "Don Bosko", SHÇBA verifikon policët që ndoqën denoncimin e Xhuljetës

## Krim i paralajmëruar, dy të rinjtë kallëzuan njëri-tjetrin në polici

Katër ditë pas krimit të dyfishtë në kryeqytet, ku Xhafer Mata vrau me armë zjarri ish-të dashurën, 19-vjeçaren Xhuljeta Çuni dhe më pas qëlloi veten, SHÇBA ka nisur verifikimin e të gjithë punonjësve të policisë që kanë trajtuar çështjen. Detajet e publikuara pas ngjarjes së rëndë, nxorën në dritë faktet se 19-vjeçarja e kishte denoncuar autorin në Komisarriatin nr.3 për përndjekje, por sipas familjarëve të saj, policia nuk mori asnjë masë. Konkretisht hetimi ka nisur ndaj punonjësve të policisë të Komisarriatit nr.3 në kryeqytet, për veprimet dhe mosveprimet e tyre në administrimin e padive, të cilat kanë paralajmëruar javë më parë vrasjen e dyfishtë në Tiranë. Ndërsa janë duke u intervistuar të gjithë punonjësit e policisë që kanë trajtuar këtë çështje, e cila përfundoi për fat të keq me dy viktima. Xhuljeta Çuni ka denoncuar pikërisht në këtë komisarriat se në kohë dhe vende të ndryshme, Xhafer Mata e përndiqte dhe e bezdiste. Nga ana tjetër, mësohet se edhe Xhafer Mata e kishte kallëzuar 19-vjeçaren për mashtrim, me pretendimin se i kishte marrë një sasi parash. Sakaq, në fund të këtij hetimi administrativ do të ketë një vendim.



Xhafer Mata

"Don Boskon", Xhuljeta Çuni kishte hyrë në Komisarriatin Nr.3 duke qarë dhe në gjendje të rëndur psikologjike. Ajo kallëzoi për përndjekje Xhafer Matën dhe më pas doli sërisht e përlotur nga ambienti e këtij komisarriati. 19-vjeçarja ka kërkuar mbrojtje nga policia pasi ndoqte dhe kërcënohet nga Xhafer Mata, i cili pas ndarjes i kërkonte kthimin e parave të marra borxh. Pas kallëzimit nga Xhuljeta Çuni në datën 7 prill 2018, procedimi ndaj Xhafer Matës është zhvilluar në gjendje të lirë. "Më datë 07.05.2018, u referuan materialet në Prokurorinë e Tiranës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shtetasin Xhafer Taip Mata, i datëlindjes 01.05.1987, banues në Tiranë, me arsim të lartë, sepse në mënyrë të përsëri-

tur, në kohë e vende të ndryshme, ka përndjekur ish-të dashurën Xhuljeta Sulejman Çuni, e datëlindjes 24.11.1999, banuese në Tiranë, me arsim 12 klasë", - thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkohë, 3 ditë përpara vrasjes, inspektori i zonës kontaktoi përmes telefonit me të ëmën e Xhuljetës Çunit, të cilën e vendos në dijeni për kallëzimin që kishte bërë e bija. Këtë e ka konfirmuar i ati i 19-vjeçares në një intervistë për emisionin "Opinion" në Tv Klan, dhënë për gazetarin Spartak Koka. Sulejman Çuni u shpreh se oficeri i zonës i siguroi atë se vajzën nuk do ta gjente asgjë pasi do të ishte në mbrojtje policore. Por tri ditë pasi policia lajmëroi familjen e Xhuljetës, 19-vjeçarja u qëllua për vdekje mëngjesin e së premtes kur po shkonte në shkollë për provimin e



Xhuljeta Çuni

maturës. Xhafer Mata nuk ishte një emër i panjohur për drejtësinë. Disa vite më parë, ai ishte përfshirë në një konflikt dhe ishte arrestuar. Pavarësisht se 31-vjeçari ishte person me precedent penal, Komisarriati Nr.3 nuk e mori mundimin për ta ndaluar pas denoncimit për përndjekje që i bëri Xhuljeta Çuni.

### NGJARJA

Më datë 08.06.2018, rreth orës 08:10, në zonën e 'Don Boskos', në rrugë "Eshref Frasheri", Xhafer Mata vrau ish-të dashurën e tij vetëm 19 vjeçe dhe më pas qëlloi mbi veten. Edhe pse u transportua menjëherë në spital ai ndërroi jetë. Vrasja ka ndodhur përpara një bar-kafeje dhe një furre buke, ndërsa dëshmitarët e shumtë janë terrorizuar nga ajo që panë. Sipas dëshmitarëve Xhafer Mata, është parë pak para krimit tek-

sa bënte lëvizje kaotike në trotuar. Ai priste të kalonte Xhuljeta, vajza që donte e me të cilën dyshohet të ketë pasur një lidhje intime. Mësohet se fillimisht Mata e ka ndaluar në rrugë dhe ajo i ka kërkuar të mos e prejë. Sipas dëshmitarëve i riu i bërtiste vajzës duke e akuzuar se e ka ndarë nga familja e tij. "Më ndave nga familja, më ndave nga femija. Më ndave nga njerëzit e mi, më shkatërrovet jetën. Pse ma bërë këtë?" Mësohet se i ka thënë Xhaferi Xhuljetës. Mësohet se pasi kanë debatuar për disa minuta vajza i ka kthyer shpinën dhe ai e ka qëlluar me një plumb. Ajo është rrëzuar në tokë ka nisur të kërkojë ndihmë, kalimtarët janë afruar, por ai iu ka drejtuar pistoletën, duke i zbrapsur e duke iu thënë të mos kishin frikë pasi nuk do t'ju bënte gjë atyre. Gjithçka ka

ndodhur në pak sekonda. Kur ka parë vajzën të lëvizte e të kërkonte ndihmë, ai i është afruar sërisht dhe e ka qëlluar në fytyrë. Xhuljeta Çuni nga fshati Vinjoll i Matit, nuk mundi t'u mbijetonte plagëve dhe pas goditjes së dytë, gjeti vdekjen e menjëhershme. 31-vjeçari nga Kukësi pasi është siguruar se e ka vranë ka vazhduar lëvizjet kaotike me pistoletë në dorë. Një grua i është drejtuar duke e pyetur se përse e vrau, ndërsa Xhafer Mata është përgjigjur i qetë "Mirë ia bëra që e vrava". Pak pas ngjarjes është parë të largohet me hapa të ngadalta, është ulur afër një peme disa metra më tutje dhe ka nisur të qajë. Në momentin që policia ka mbërritur në vendngjarje, Xhaferi ka qëlluar veten me një plumb në kokë, ndërsa një orë pas ngjarjes ka ndërruar jetë në spital.

Ai nuk ka mundur t'i mbijetojë plagës së rëndë të shkaktuar nga një plumb në kokë ndonëse u transportua menjëherë pranë Qendrës Spitalore të Traumës. Ka qenë e pamundur madje të ndërhyhej nga mjekët për të hequr plumbin për shkak të dëmtimit shumë të madh. Mjekët e kanë klasifikuar si një rast terminal që në mbërritjen e tij në spital. Mësohet se Xhafer Mata ishte divorcuar në dhjetor të vitit 2017, ndërsa kishte një djalë 1 vjeç. Ndërkohë fëmijën e mbante ai bashkë me prindërit e tij. Mata kishte krijuar një lidhje jashtë-martësore me Xhuljetën, marrëdhënie që uoi edhe në divorc. Pavarësisht se hoqi dorë nga martesja e tij, lidhja me Xhuljetën zgjati vetëm 6 muaj. Po ashtu mësohet se vajza punonte në një supermarket afër banesës së djalit.

### DENONCIMI

Xhuljeta Çuni kishte bërë denoncim në polici më 7 maj ndaj Xhafer Matës për përndjekje. E megjithatë, 31-vjeçari as nuk ishte ndaluar apo arrestuar nga uniformat blu. Një muaj para tragjedisë që tronditi

Përmbasurit gjyqësore Genti Bushati nxjerr për shtjpe në ankan pasurim :

"Toko Are me sip 865 m2 , me Nr pasurie 131/86 Zona kadastrale nr 1896 Volumi 9 , fage 44 , me vendndodhje Grude e re Shkoder .  
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shtjpa në Ankan për pasurimë e sipërpeshkruar është në vlerën 336.000 (Treqind e triqindet e gjashtë mijë) Lekë .

Shtjpa e pasurimë do të behet ( zhvillohet ) me date 18.06.2018 ora 16.16 në Zyrën e përmbasurit gjyqësore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko . Përballë Gjyqësorit të Tiranës . Personat e interesuar duhet të derdhin përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.

### STRATI

Shoqëria përmbasimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shtjpe në ankan të pasurimë të palaujtshme:

"Atë" me sipërfaqe 3000 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Tiranë, Kashar, regjistruar në pronësi të Eduard Zadoja, me Nr. Pasurie 115236, Zona Kadastrale Nr. 2105, volumi 17, fage 154, regjistruar në Zyrën e Pasurive të Palaujtshme Tiranë, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 321 Rep dhe Nr. 125 Kol datë 12.02.2007. Çmimi fillestar i ankandit është 246.960 Euro.

Ankandit për pasurimë e mësipërme zhvillohet në datë 18.06.2018. Ankandit për pasurimë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbasimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Veliu: Motorët e ujit e skafet vetëm në zona të veçuara, me qëllim parandalimin e ngjarjeve aksidentale

# Sezoni turistik, ministri Xhafaj takim me prefektët dhe drejtuesit më të lartë të policisë

*"Zero tolerancë, luftë pa kompromis për shkelësit e ligjit"*

Durrës

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj zhvilloi ditën e djeshme në Shtëpinë e Pushimit në Durrës një takim me prefektët, drejtuesit kryesorë të Policisë së Shtetit në Drejtorinë e Përgjithshme, drejtoritë vendore dhe komisarite. Takimi u fokusua në disa çështje kryesore. Konkreisht në mbarëvajtja dhe masat për sezonin turistik;

luftën kundër kanabisit, i cili mbetet një prioritet i qeverisë nën moton "Zero tolerancë"; si dhe nismën "Policimi në komunitet" që po vijon me llogaridhënien e policisë përballë qytetarëve. Duke u ndalur në sezonin turistik, ministri Xhafaj theksoi se pritsmëritë e qytetarëve, turistëve dhe operatorëve turistikë janë të mëdha. Xhafaj kërkoi luftë pa kompromis për shkelësit e ligjit dhe zero tolerancë gjatë sezonit turistik në vend. "Edhe interesi është shumë i lartë i operatorëve, vendas, të huaj në këtë fushë, por edhe pritsmëria e njerëzve të thjeshtë, e qytetarëve që presin një shërbim shumë më të mirë, është shumëfish më e lartë, çfarë nënkupton më shumë përgjegjësi për ne. Sivjet mbështetur në një përvojë shumë të mirë analizën e së cilës ne e kemi bërë në nëntor të 2017, për çfarë kemi pasur problematika gjatë sezonit të kaluar dhe reflektimet përkatëse, do të mund të na ndihmojnë që të mund të japim parametra shumë më të lartë qetësie dhe sigurie tek qytetarët dhe të gjithë operatorët turistikë në këtë sezon", nënvizoi ministri Xhafaj. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Ardi Veliu u kërkoi drejtuesit të policive ven-



Ministri Brendshëm Fatmir Xhafaj gjatë takimit me prefektët dhe drejtuesit kryesorë të Policisë së Shtetit

**FATMIR XHAFAJ**

"Sivjet, mbështetur në një përvojë shumë të mirë analizën e së cilës ne e kemi bërë në nëntor të 2017, për çfarë kemi pasur problematika gjatë sezonit të kaluar dhe reflektimet përkatëse, do të mund të na ndihmojnë që të mund të reflektojmë më mirë dhe të japim parametra shumë më të lartë qetësie dhe sigurie tek qytetarët dhe të gjithë operatorët turistikë në këtë sezon", nënvizoi ministri Xhafaj.

dore dhe shefave të komisariteve të jenë të vendosur për të zbatuar oraret dhe kufizimet e vendosura nga pushteti vendor për të mos lejuar ndotjen akustike. Ai

kërkoi nga vartësit ndëshkim për këdo që tej orareve të përcaktuara krijon ndotje akustike, si dhe kufizimet në plazhet ku lejohen motorët e ujit për të shmangur

qarkullimin e mjeteve motorike, qofshin gomone, skafë të vegjël apo motorë uji, me qëllim parandalimin e ngjarjeve aksidentale", u shpreh drejtori Veliu. Një tjetër fokus i policisë për këtë periudhë janë dhe pikat kufitare, ku në çdo të tillë do të punohet me kapacitete maksimale për të shmangur radhët e gjata dhe pritjet në kufi për turistët dhe kalimtarët. Gjithashtu, zv.drejtorja e përgjithshme e Policisë së Shtetit Aida Hajnaj bëri një prezantim të detajuar të paketës së masave të marra nga policia për mbarëvajtjen e këtij sezoni. "Për të përballuar me sukses këtë sezon turistik u bë një studim dhe përcaktim i plazheve me qëllim përcaktimin e risqeve në drejtim të sigurisë. Është bërë planifikim i punonjësve të policisë, mjeteve dhe pajisjeve shtesë, ngritja e 5 stacioneve provizore të policisë; përforcim i shërbimeve të policisë me shërbime të Ndërhurjes së Shpejtë; dhe shtimi i sporteve për pikat e të gjitha hyrje-daljet në pikat kufitare", shtoi ndër të tjera Hajnaj.

**ARDI VELIU**

"Për sa i përket pjesës së kufizimit dhe rritjes së sigurisë në ujë, për sa i përket kufizimeve që duhet të bëjmë në hapësirat apo në pjesët ku janë përcaktuar për plazhe, qofshin këto publike apo private, nuk do lejojmë qarkullimin e mjeteve motorike, qofshin gomone, skafë të vegjël apo motorë uji, me qëllim parandalimin e ngjarjeve aksidentale", u shpreh drejtori Veliu.

**SHKURT**

**Nën akuzë për gjobevenie dhe kërcënim, mbyllet shqyrtimi i dosjes "Shullazi"**

Das 42 seancash gjyqësores është mbyllur ditën e djeshme shqyrtimi i dosjes për grupin "Shullazi". Më datë 26 qershor prokuroria do të paraqesë konkluzionet përfundimtare për Emiljano Shullazin dhe katër të pandehurit e tjerë, Gilmando Dani, Blerim Shullazi, Endrit Qyqja, Endrit Zela, ndërkohe që Gjykata ka administruar të gjitha provat shkresore. Mësohet se në seancën e djeshme pala mbrojtëse kërkoi të thirren si dëshmitarë disa punonjës të një banke të Nivelit të Dytë për të dëshmuar mbi disa çeqe që kanë lëshuar në emër të Gilmando Danit dhe Endrit Qyqes, por kërkesa nuk u pranua nga gjykata. Gjyqi për këtë çështje filloi në 10 maj të vitit të kaluar dhe gjatë seancave pati debate të forta mes prokurorisë, të pandehurëve dhe dëshmitarit të mbrojtur, biznesmenit Ylvi Begja. Banda "Shullazi" akuzohet për veprat "shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë", në dëm të tre biznesmenëve. "Shkatërrim të pronës me eksploziv" në dy raste, dhe "kanosjes për shkak të detyrës" të profesorëve Dhori Kule e Mynyr Koni, krime të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal.

**Nën akuzë për trafik ndërkombëtar droge, zgjaten me tre muaj hetimet për Klement Balilin**



Zgjaten me tre muaj të tjera hetimet për Klement Balilin, i konsideruar si "Eskobari i Ballkanit". Mësohet se prokuroria e Krimeve të Rënda, i ka zgjatuar hetimet për shkak të verifikimeve në shtetin grek për këtë çështje. Kjo pasi Prokuroria e Krimeve të Rënda i ka nisur një letër-porosi autoriteteve greke në lidhje me Klement Balilin, i akuzuar për trafik ndërkombëtar droge dhe i shpallur në kërkim. Or-

gani i akuzës kërkoi të dhënat nga Greqia për mbylljen e procesit. Pala greke ka sjellë materialet e para për Klement Balilin, ndërsa në Greqi po zhvillohet një gjyq me disa të pandehur, të cilët dyshohet si bashkëpunëtorë të Balilit në rrjetin e trafikut të drogës. Pala shqiptare ka kërkuar aktet e bashkëlidhura nga pala greke dhe pasi të ketë dosjen e plotë do të vendosë për çështjen 'Bailli'.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: -- ITB- Procurement of Central Infrastructure for OSSH Service Delivery in Albanian LGUs

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked UNDP/RFP 47098

ITB- Procurement of Central Infrastructure for OSSH Service Delivery in Albanian LGUs For more details please refer to the link below:

<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 03 July 2018

Address for communications:  
 Email: [procurement.al@undp.org](mailto:procurement.al@undp.org)  
 Or  
 Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2<sup>nd</sup> floor  
 Tirana, Albania



Masakra në Nicë

## Akuzohej se furnizoi me armë autorin e masakrës së Nicës, vetëvritet në burg shqiptari Aleksandër Hasalla

**FRANCË** - Një 38-vjeçar shqiptar i akuzuar për akte terroriste i ka dhënë fund jetës në një burg të Francës. Mediat franceze shkruajnë se Aleksandër Hasalla u gjet i vdekur në qelinë e tij, në burgun e Fleury-Mérogis të Francës. Shqiptari ishte arrestuar në dhjetor

të vitit 2016, pasi akuzohej se kishte furnizuar me municione terroristin e masakrës së Nicës më 14 korrik 2016, ku u vranë 86 persona dhe mbetën të plagosur 450 të tjerë, pasi u shtypën me kamion. Autori i kësaj masakre, tuniziani Mohamed Lahaiey Bouhleb kreu

sulm vetëvrasës, ndërsa sipas mediave franceze shqiptari kishte pasur rol periferik. Shqiptari akuzohet se i kishte siguruar terroristit një kallashnikov dhe një pistoletë automatike. Aleksandër Hasalla ishte i njohur nga drejtësia franceze për grabitje në të kaluarën,

por akuzua ndaj tij lidhur me aktin terrorist nuk ishte provuar plotësisht.

Dyshohet se shqiptari është vetëvuar me lidhëset e këpucëve. 38-vjeçari është i burgosur i dytë në Francë për aktet e terrorizmit, i cili kryen vetëvrasje në paraburgim

Massimiliano: Shqiptarja ishte prostitutë?! Jo për sa kisha unë dijeni

# Vrasja mizore e 20-vjeçares në Itali, ish-burri: Nuk e meritonte këtë fund

*“Ishte një vajzë gjithnjë e qeshur, kaq e re”*

**ITALI**

**P**ak ditë pas vrasjes së shqiptares Anxhela Meçani në Torino të Italisë, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen. Mësohet se 20-vjeçarja, e cila mbrëmjen e së dielës u dhunua barbarisht dhe më pas u hodh nga një makinë që ishte në lëvizje kishte jetuar për disa vite në Ravenna, megjithatë ajo rezultonte e regjistruar si banore atje që prej majit, pas martesës me një italian. Sipas mediave të vendit fqinj, pikërisht në Ravenna, në një apartament në rrugën Cairoli jeton ende Massimiliano, ish-bashkëshorti i saj me origjinë nga Lecce, me të cilin po ndahej. “Nuk dija asgjë. Unë dhe Anxhela ishim ndarë prej disa muajsh. Ajo kishte ikur nga shtëpia, kishte marrë këtë vendim dhe unë e kisha respektuar”.

similiano telefonoi partnerin e ri të 20-vjeçares, pa ditur asgjë se çfarë kishte ndodhur. “Më tha vetëm që nuk mund të fliste, që ishte



në polici dhe se e kishin vranë. Fillimisht mendova një aksident. Ishte prostitutë? Jo për sa kisha unë dijeni. Kur

rrinte me mua në Ravenna, nuk kam kuptuar kurrë asgjë. Pas kësaj nuk di se çfarë mund të ketë bërë”, -thotë Massi-

miliano, ndërsa më pas shton: “Ishte një vajzë gjithnjë e qeshur. Nuk meritonte këtë fund, ishte kaq e re...” Ndërsa duke iu referuar vrasjes së mundshme, ai shprehet se kushdo që ka bërë diçka të tillë është një fundërrinë. “Mund të zihesh, por nuk mund të arrih të vrasësh dikë në atë mënyrë. Vetëm mendimi për t'i bërë keq dikujt është prej injoranti dhe barbari. Për fat të keq kjo shoqëri po shkon drejt kësaj rruge...”

Anxhela kishte mbushur 20 vjeç në mars. Ajo kishte me vete vetëm një celular dhe një fotokopje të dokumentit të identifikimit. Në polici ekziston vetëm një fotografi e saj, pjesë e dokumenteve për kërkesën e bërë për lejen e qëndrimit të tyre”, thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.



**Zarf me fishek mbi xhamin e makinës, kërcënohet i riu**

**FIER** - Një 30-vjeçar nga Fieri ka bërë denoncim në polici se është kërcënuar me jetë. I riu ka deklaruar para bluve se persona të panjohur i kishin lënë të fshirësja e xhamit të makinës një zarf me një fishek. Mësohet se ngjarja ka ndodhur dy ditë më parë. “30-vjeçari me inicialet A.N. banues në Fier ka deklaruar në polici se dje (të hënën) rreth orës 07:30 kur është drejtuar për te makina tip “Toyota”, parkuar pranë banesës ka gjetur zarfin me plumbin brenda. Pas kallëzimit në polici, grupi hetimor po punon për identifikimin dhe arrestimin e autorëve”, -thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

### Avokati, gjykatës: Vuan nga diabeti

## U arrestua për korrupsion, lihet i lirë dekani Albert Riska

**ELBASAN** - Gjykata e Elbasanit ka liruar nga burgu dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, Albert Riska, i cili u arrestua një muaj më parë për korrupsion. Togat e zezë të këtij qyteti dje zëvendësuan masën e sigurisë për Riskën nga Arrest me burg në Arrest shtëpie. Vendimi është marrë, pasi avokati ka kërkuar lirinë, pasi klienti i tij vuan nga diabeti. Pas shqyrtimit të

raportit shëndetësor, gjykata e Elbasanit vendosi lirinë e dekanit. Më 9 maj të këtij viti, në kuadër të operacionit ‘Dekani’ u arrestua dekani i Albert Riska; shefja e Departamentit të Gazetarisë, Elvira Lumi si dhe pedagogja e jashtme Erjola Calja. Ata u prangosën, pasi akuzohen se u marrin para studentëve kundrejt kalimit në provime. Pas arrestimit për korrupsion, rektori i këtij universiteti i pezulloi nga detyra deri në

zbardhjen e plotë të çështjes. Ndërkaq, u arrestuan dhe tre sekserë e një student. Bëhet fjalë për shtetasit: Petrit Kodra, banues në Elbasan; Admirim Kala, banues në Tiranë; Adem Ngjela, banues në Cërrik dhe studentin Marius Calja, banues në fshatin Gostim të Cërriku. Këta të fundit akuzohen për veprën penale: “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”.


## Ngacmoi seksualisht nusen e djalit dhe vajzën e tij, bie në pranga 50-vjeçari

**ELBASAN** - Një 50-vjeçar është arrestuar nga policia, pasi akuzohet se ka dhunuar dhe ngacmuar seksualisht nusen e djalit dhe vajzën e tij të mitur. Bëhet fjalë për shtetasin Filip Qosen nga fshati Mjekës, njësi administrative Shirgjan në Elbasan. “Shtetasi i lartpërmendur, dyshohet se ka dhunuar dhe ngacmuar seksualisht nusen e djalit, shtetasen E.Q. 22 vjeçe si dhe vajzën e tij të mitur shtetasen E.Q., 14 vjeçe banuese në fsha-



tin Mjekës. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprat penale: “Dhuna në Familje” dhe “Vepra të turpshme”, -thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Elbasanit.





Banesa e familjes Shaholli në Durrës

“Nusen e mbuluar nga gjaku e çuan fqinjët në spital, më ndihmoni të rris jetimët”

Klodiana Haxhij

DURRËS

“Që prej pesë ditësh, në familjen Shaholli janë hapur dyert e mortit. Të afërm, miq dhe të njohur hyjnë e dalin në shtëpinë njëkatëshe, e cila vetëm shtëpi nuk mund të quhet. Banesa është me soletë betoni, e pa savatuar jashtë dhe brenda. Dritaret, në vend të xhamave kanë plasmas. Brenda skamja të vret sytë. Nuk ka frigorifer, vetëm ca kolltukë të vjetra të falura. Një televizor i vogël i kohës së diktaturës. Aty gjejmë prindërit e moshuar të 42-vjeçarit Çlirim Shaholli, i cili mbrëmjen e së premtes që shkoi masakroi gruan e tij, nënë e 6 fëmijëve. Zaim dhe Naile Shaholli janë të dërmuar nga krimi makabër i djalit të tyre të vetëm. 77-vjeçari na pret me lot në sy “Nuk e di çfarë i kam bërë Zotit unë i ziu që më dënoi në këtë moshë”, thotë plakuri. Ndërkohë, në një intervistë për “Gazeta Shqiptare”, Zaim Shaholli deklaroi se e ka bërë hasha djalin e tij, pasi i la 6 fëmijët pa nënë. Ai tregoi se djali i tij vrasës, Çlirim Shaholli nuk punonte dhe se familja prej 10 anëtarësh mbahej me pensionin e tij dhe të bashkëshortes, Nailes. “Pensionin tim prej 87 mijë lekë të vjetra e lja në bankë, pasi na prenë dritat. Por lekët e pensionit nuk mjaftonin, pasi shuma që kishim për të paguar ishte e madhe. Unë me plakën time ngjyenim bukën në kripë e qepë dhe lekët e pensionit ia jepnim djalin që të rriste 6 vocërrakët e tij. Aina bëri hatanë, ndaj nuk do ia shoh më sytë”, tha babai i 42-vjeçarit vrasës.

**Zoti Zaim, ku ishit ju kur ndodhi ngjarja?**

Ne jetojmë në një banesë me djalin dhe fëmijët e tij, por ditën kur ndodhi gjëna nuk ishim në Durrës. Unë dhe bashkëshortja kishim shkuar në Maliq te vëllai im, pasi ai kishte një sebeb.

**Si e mësuar lajmin për vrasjen e nuses, Ardianës?**

Erdhi vëllai im, Halili e më tha të dilnim jashtë se kemi për të biseduar. Ai kishte parë lajmet në televizor

# Zaim Shaholli: Djalin tim të vetëm e kam bërë hasha, la 6 fëmijë pa nënë

“Unë me plakën time ngjyenim bukën në kripë e qepë dhe lekët e pensionit ia jepnim që të rriste vocërrakët e tij”



Zaim dhe Naile Shaholli duke folur për “GSH”



Viktima Ardiana Shaholli

## NËNA E VRASËSIT

Naile Shaholli është tejet e tronditur nga krimi i kryer nga djali i saj i vetëm, Çlirimi. “Nuk e mendoja kurrë se djali do vriste nusen, nënën e 6 kalamajve të tij, pavarësisht se ai grindej me Ardianën. Prindër për kalamajtë do bëhemi unë dhe plakuri. Frymën do e kemi për këta të gjashtë. Ne kërkojmë ndihmë që të rritim dhe të shkollojmë fëmijët”, - tha nëna e 42-vjeçarit vrasës.

## MËSUESIT

Gjyshërit e 6 fëmijëve të mbetur jetimë, dje kanë pritur për ngushëllim 110 mësues të shkollës 9-vjeçare “Demokracia” dhe të gjimnazit në zonën e ish-Kënetës në Durrës. I përlotur, Zaim Shaholli u tha mësuesve se nuk kam fjalë t’ju them. Më është thyer zemra dhe jam krejt i rrënuar dhe nuk gjej fjalë për krimin që bëri im bir e që la 6 fëmijë pa nënë. Mësohet se 6 fëmijët e çiftit Shaholli, ndonëse të zhytur në mjerim janë nxënë të shkëlqyer.



dhe kishte mësuar se im bir kishte masakruar nusen. Më ra qielli në kokë kur dëgjova lajmin e kobshëm, gjëmën që kishte bërë Çlirimi. Në atë çast thirra i dëshpëruar: Ç’na bërë o bir, ç’na bërë. Ç’është kjo hata!

**A kishin konflikte mes djalit dhe nuses?**

Prej më shumë se një viti ata kishin konflikte të vazhdueshme. Sherret zinin fill nga varfëria dhe mjerimi në familjen tonë.

**A punonte djali juaj dhe kush e mbante familjen?**

Në fillim kur erdhëm nga Maliq në Durrës, para 13 vitesh, ai kërkoi punë, por nuk gjeti. Pastaj as nuk interesohej më. Çlirimi nuk

ka asnjë lloj zanati dhe nuk punonte, ndërsa nuk lejonte as nusen e tij, Ardianën prej një kohe të gjatë që të hynte në punë. Ajo kishte pak kohë që kishte nisur punë. Familja prej 10 pjesëtarësh mbante frymën gjallë me lekët e pensionit tim dhe të time shoqe.

**A pinte alkool djali juaj?**

Pinte me raste, pasi në nuk e linim, por nuk kishte ku të gjente dhe lekë që të dilte e të pinte nëpër lokale.

**Po fëmijët si e përjetuan humbjen e nënës së tyre?**

Çfarë të thotë gjyshi për ta. Shpendi është më imadhi, 18 vjeç. Vëllai i vetëm i 5 motrave. Ai sa ka mbaruar maturën dhe ka pak kohë që

ka filluar punë si kamarier në Golem. Fëmija i dytë është Vera, 17 vjeçe. Edhe kjo ka filluar punë para ca ditësh në një fas-food. Vajza e tretë është 16 vjeçe.

**Po tre fëmijët më të vegjël morën pjesë në ceremoninë e varrimit dhe a dinë gjë për vdekjen e nënës së tyre?**

Ne i morëm të më të vegjlit ditën e varrimit dhe i çuam te shtëpia e fqinjit. Nuk kishim kurajo t’i çonim në varrim. Pas ceremonisë i morëm në shtëpi. Fëmijët ishin të tronditur dhe rrinin si të shushatur. Nuk flisnin. Vetëm e vogla 8 vjeçe vinte vërdallë nëpër shtëpi e po lozte me kukul-

lat, pasi nuk e kuptonte se çfarë kishte ndodhur. Të nesërmen, një ditë pas varrimit të nuses së djalit, 3 fëmijët e vegjël i mori një shoqatë dhe i çoi në kamp veror.

**Kush gjeti Ardianën të vrasë në shtëpi?**

E gjeti vajza e saj e madhe, Vera, e cila sa kishte ardhur nga puna. Nga tronditja e madhe, ajo kishte dalë jashtë dhe kishte thirrur fqinjët, duke u thënë: Hajdeni se mami është mbuluar nga gjaku.

Të atin nuk e kishte gjetur në shtëpi, pasi ai ishte larguar pasi kishte goditur nusen. Fqinjët e kishin gjetur të gjallë dhe me puls Ar-

dianën. Ata i kishin dhënë ndihmën e parë. Më pas kishin gjetur një makinë dhe e kishin dërguar në spitalin e Durrësit.

**Po djali juaj ka deklaruar në polici se e ka çuar ai në spital Ardianën dhe se e ka mbajtur në krahë.**

Jo nuk është e vërtetë. Nusen e kanë çuar fqinjët në spital. Ai ka qenë aty rrotull dhe më pas ka shkuar dhe ai në spital.

**Cili është apeli juaj?**

U kërkoj ndihmë të gjithë atyre që kanë mundësi financiare që të na ndihmojnë me sa mundën, qoftë dhe për të paguar dritat dhe ujën e pijshëm. I bëj apel shtetit që të na ndihmojë, pasi tani kam 6 fëmijë për të rritur. Tani jam unë baba për ta dhe pse në moshë të thyer.

Ish-pronarët që janë kundër vlerësimit financiar që ka vendosur 'Agjencia' mund të ankimojnë

# Dosjet 1999-2000, pronarët 30 ditë afat për ankimim në gjykatë

*Përfituesit marrin 20% të vlerës së pronës në para dhe 80% kompensim fizik*

Ornela Manjani

Pronarët që janë njohur me vlerësimet financiare të viteve 1999 dhe 2000 kanë të drejtë që brenda 30 ditëve të paraqesin ankimin në Gjykatën e Administrative, në rast se nuk janë dakord me vlerësimin që ka dhënë Agjencia e Trajtitimit të Pronave. ATP ka publikuar dy ditë më parë regjistrin e vendimeve për individët që u është njohur e drejta për kompensimin e pronave për vitet 1999 dhe 2000. Lista për vitin 1999 përmban 1239 emra, ndërsa ajo e vitit 2000 përmban 837 emra. Në rast se pronarët që nuk janë dakord me vlerësimin nuk paraqesin akimimin brenda afateve, vendimi kthehet në titull ekzekutiv dhe ata s'mund të ndjekin më asnjë rrugë ligjore për korrjigimin e vendimit. Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka përfunduar procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare për dosjet e vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara në të gjithë vendin. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për ko-



mpensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikat në vlerësimin jepen të detajuara për çdo dosje.

## APLIKIMI PËR KOMPENSIM

Pronarët që janë dakord me vlerësimin e ATP-së kanë gjashtë muaj kohë për të plotësuar dokumentet. Përfituesit duhet të dorëzojnë në ATP shtatë dokumente në të marrë 20% të

vlerës së pronës në para dhe 80% kompensim fizik. Shifrat janë bërë të ditura nga burime zyrtare pranë Agjencisë së Trajtitimit të Pronave sipas të cilave mësohet se të gjithë pronarët, për dosjet e të cilëve është dhënë një vlerësim duhet të paraqiten në 'Agjencinë' për të dorëzuar kërkesën për kompensim, konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet

dhe nëse është ushtruar ajo e drejta e parablerjes (nëse është njohur në vendim), dëshmi trashëgimie, prokurë, deklaratë noteriale të nënshkruar nga subjekti i shpronësuar, vërtetim për numrin e llogarisë bankare, dokument identifikimi dhe mandat pagese.

## DOSJET

Ish-pronarët që kanë aplikuar për kthim dhe kompensim prone në Agjenc-

- DOKUMENTET**
1. Kërkesë për kompensim.
  2. Konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes (nëse është njohur në vendim).
  3. Dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve.
  4. Prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre.
  5. Vërtetim për numrin e llogarisë bankare.
  6. Dokument identifikimi.
  7. Mandat pagese.

inë e Trajtitimit të Pronave dhe nuk janë njohur ende me vendimin e 'Agjencisë' mund të kërkojnë informacion në lidhje me fazën në të cilën ndodhet dosja. Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka në dispozicionin të pronarëve formularin tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili

duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjencinë' për t'u njohur me fazën në cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtitimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

## "Objektiv i çdo qeverie, rritja e mirëqenies".

### Ministri Ahmetaj: Njohje e certifikatave sanitare

Qeveria shqiptare është duke punuar për heqjen e barrierave doganore për bizneset, ndërkohë që aktualisht fokusi është vendosur te njohja reciproke e certifikatave sanitare mes vendeve të rajonit. Lajmi u bë i ditur nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, teksa foli për pengesat që has sipërmarrja në tregun rajonal. Ministri i Financave tha se do të punohet edhe në drejtim të infrastrukturës, pasi me kushtet aktuale, ajo shton kostot kohore dhe ekonomike. Ndërkaq, drejtoresha e përgjithshme e Doganave u ndal te përmirësimi i infrastrukturës doganore, ndërsa kërkoi rritje të bashkëpunimit në drejtim të shkëmbimit të informacioneve mes vendeve të rajonit. Deklaratat u



bënë gjatë një takimi të zhvilluar në Tiranë, në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe sfidave të administratës doganore të rajonit, ku morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë dhe ambasadorë. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, gjatë një takimi me drejtoritë e doganave në rajon, deklaroi se qeveria shqiptare është e orientuar drejt bashkëpunimit. Po ashtu, ministri tha se objektivi i çdo qeverie është që të rritet mirëqenia, ndërsa shtoi se synim është lehtësimi i tregëtisë në rajon. "Objektivi i çdo qeverie është rritja e mirëqenies. Qeveria duhet të heqë

barriera jotarifore. Ne jemi të orientuar për bashkëpunim rajonal. Nëse qasja e natyrshme është lehtësimi i lëvizjes, ne po marrim masa konkrete. Synojmë lehtësimin e tregëtisë në rajon. Rajoni nuk ka një infrastrukturë në atë nivel, rrugore kryesive, që të bëjë të mundur një lëvizje tregtare. Jeni njohur të gjithë projektin e Bankës Botërore, që akuzon si të thuash administratat. Por, sfida për këtë kosto kohore, e përkthyer edhe në vlera monetare është ta zërojë. Qeveria shqiptare ka hyrë në një fazë të re, transformuese", tha Ahmetaj.

## Kredia për individë, në prill interesat ranë në nivelet më të ulëta të 2018-ës

Normat e interesit të kredisë për individë prekën nivelet më të ulëta të vitit 2018 gjatë muajit prill. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, kreditimi i individëve ishte më i lirë në të gjitha valutat dhe në shumicën e produkteve bankare për këtë segment të tregut. Për kreditë në lekë, interesi mesatar zbriti në 6.83%, për ato në euro në 3.33% dhe për kreditë në dollarë amerikanë në 5.26%. Në dy vitet e fundit, bankat po aplikojnë standarde gjithnjë e më të lirshme në kredinë për individë dhe normat e ulëta të interesit janë një ndër elementët më të dukshëm. Normat e ulëta të interesit po favorizohen nga politikat monetare stimuluuese dhe nga gjendja e lartë e likuiditetit të sistemit bankar. Gjatë muajve të parë të këtij viti, normat e interesit kanë rënë edhe në instrumentet e borxhit qeveritar. Ulja e mëtejshme e normës bazë të interesit javën e kaluar nga Banka e Shqipërisë mund t'i japë një shtyesë të mëtejshme uljes së normave të interesit për lekun. Ndërkohë, deri tani publikimi i strategjisë së deeurizimit nuk duket të ketë pasur ndonjë efekt në rritjen e interesave të produkteve bankare në euro. Rregulloret e kësaj strategjie do të hyjnë në fuqi së shpejti, por deri tani bankat nuk kanë ndërmarrë ndonjë korrektime të gmimeve, çka tregon se nuk presin rritje të rëndësishme të kostove. Në fund të muajit prill portofoli i kredisë për individë kishte vlerën e afro 171 miliardë lekëve, në rritje me 5% krahasuar me një vit më parë. Kredia për individët po rritet sidomos në lekë, si në kreditë për blerje të shtëpive, ashtu edhe në ato për konsum.



Paketë financiare edhe rrugën e re Kashar-Rrogzhiinë

Ornela Manjani

Tiranë dhe Durrësi do të lidhen me një rrugë me pagesë dhe një pa pagesë. Ose autostrada Tiranë- Durrës ose Tiranë-Ndroq-Plepa do të jenë me pagesë, e cila do të vendoset pas ndërhyrjeve rindërtuese që do të nisnin në të dyja akset. Lajmi është bërë i ditur nga kryeministri Edi Rama pasi është pyetur nga gazetarët nëse në projektin e zgjerimit të superstradës Tiranë-Durrës do të përfshihen investitorët privatë. Rama deklaroi se do të ofrohen dy rrugë alternative, nga të cilat për njërin do të aplikohet tarifë. "Do të jetë një ndërhyrje e thellë rindërtuese dhe varianti që po studiojmë është një variant miks midis rindërtimit dhe zgjerimit të aksit Tiranë-Durrës dhe rindërtimit të aksit Tiranë-Ndroq-Plepa, ku do të krijojmë dy alternativa, nga ku njëri do të jetë me pagesë dhe tjetri pa pagesë. Deri në mes të korrikut besoj do të kemi një qartësi. Më pas do të shikojmë ku shkon më arsyeshëm ku shkon llogaria dhe do të jemi transparent me publikun. Bëhet fjalë për një paketë të madhe financiare që përfshin edhe rrugën e re Kashar-Rrogzhiinë, që do të sillte një shkurtim të ndjeshëm të lidhjes mes Tiranës dhe Vlorës", tha kryeministri. Këshilli i Ministrave ka miratuar gjatë mbledhjes së fundit të qeverisë në Durrës një paketë investimesh për qarkun. Sipas kryeministrit Edi Rama, bëhet fjalë për 100 projekte që do të financohen tërësisht nga buxheti i shtetit, të cilat do t'u bashkëngjiten 123 projekteve në proces dhe qindra projekteve të tjera që do të financohen në vijim nga donatorë të huaj.

**100 PROJEKTET**

Kreu i qeverisë tha dhe pas përfundimit të mbledhjes së Këshillit të Ministrave se janë miratuar 100 projekte që do të financohen nga buxheti i shtetit, të cilat janë të fokusuar konkretisht në infrastrukturën rrugore, zgjerimi i disa akseve të rëndësishme, si dhe rikonstruksioni i qendrave shëndetësore, godinës së pediatriisë, si dhe disa sh-

# Kryeministri Rama: Tiranë-Durrës ose Tiranë-Ndroq-Plepa do të bëhet me pagesë

## Qeveria miraton 100 projekte investimi në Durrës



Kyeministri Edi Rama

### Akset dhe automjetet që do të ndalohen të qarkullojnë

Duke nisur nga dita e premte do të nisi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin rrugor të mallrave përgjatë sezonit turistik dhe festave. Referuar udhëzimit të publikuar ditën e sotme në "Fletoren Zyrtare", ndalohet qarkullimi i një sërë mjesh rrugore. Këto të fundit përfshijnë mjete me peshë të përgjithshme të autorizuar mbi 7.5 tonë; me ngarkesë të pa-

dashme me gjatësi maksimale më të madhe se 12 m; makinat bujqësore, makinat teknologjike ose traktorët me rrota që kanë shpejtësi më të vogël se 40km/orë; makinat bujqësore teknologjike që kalojnë përmasat kufitare si dhe makinat për kursantët e autoshkollave. Udhëzimi do të jetë i vlefshëm deri në 15 shtator. Ndërkohë, lejohen të qarkullojnë automjetet e shoqërimit, automjetet e forcave të Armatosura, për

mirëmbajtjen e rrugëve, mjetet që i përkasin radios dhe televizionit, cisternat që transportojnë ujë të pijshëm, kamionë dhe tërheqës me gjysmërimorkatorë, kamionë që transportojnë shpendë dhe bagëti të gjalla. Gjatë kësaj periudhe të kufizimit, mjetet e huaja me peshë mbi 7.5 tonë ose mbi 12 m gjatësi nuk mund të hyjnë në Shqipëri, por mund të përdoren vendin e parkimit ose zonën kufitare përkatëse.

### Segmenti Tiranë-Vorë

#### Fondet për rikonstruksionin nga Banka Botërore

Ministria e Infrastrukturrës bën të ditur se fondet për rikonstruksionin e segmentit Tiranë -Vorë janë dhënë nga Banka Botërore. "Ndërhyrja bëhet si emergjente për rritjen e elementeve të sigurisë rrugore. Në këtë ndërhyrje do të riparohen shtresat në pjesët e dëmtuara dhe jo e gjithë gjatësia e rrugës. Pra, bëhet fjalë për riparim të shtresave rrugore në zonat e dëm-

tuara, të cilat krijojnë probleme qarkullimi. Gjithsej 31000 metra katrorë shtresa asfaltike, kostoja 615 mijë euro me TVSH nga fondet e Bankës Botërore nga projekti i mirëmbajtjes si ndërhyrje emergjente ku mbi 90% e zë drejtimi i lëvizjes nga Tirana në Durrës. Për rehabilitimin e plotë të të gjithë segmentit po punohet nga ARRSH për sigurimin e fondit nga buxheti i shtetit", bëjnë të ditur burime zyrtare nga Ministria e Infrastrukturrës.

shihen projekte që kanë të bëjnë me rrugët, jemi ndërkohë në një proces studimi dhe rivlerësimi për rindërtimin dhe rrizgjerimin e rrugës Tiranë-Durrës, apo hapjen e rrugës së re Kashar-Rrogzhiinë, si dhe zgjerimin e aksit nga Rrogzhiina në Fier. Parashikohet rehabilitimi i plotë i rrugës Durrës-Shiak, sistemin e aksit Fushë-Krujë-Milot-Morinë. Jemi në një fazë të avancuar të një projekti të madh për rindërtimin e të gjithë rrugëve të brendshme dhe rikualifikimin urban të hapësirave publike brenda një blloku të konsiderueshëm në Shkëmbin e Kavajës. Jemi afër përfundimit të proceseve për korridorin hekurudhor që do lidhë Durrësin me Tiranën dhe Rinasin përmes një linje të re të standardeve europi-

ane. Parashikohen edhe një sërë investimesh që lidhen me qendrat shëndetësore, furnizimin me ujë, rindërtimi i godinës së pediatriisë në spitalin e Durrësit, rikonstruksionin i dhjetëra shkollave, etj. Në Durrës janë 6 fshatra pjesë e programit të 100 fshatrave. Po kështu kemi edhe një program për financimin e agro-turizmit", tha kryeministri Rama. Ai u shpreh ndër të tjera se projekti i mirëmbajtjes së autostradës Tiranë-Durrës pritet të përfundojë brenda qershorit. "Na është dashur një periudhë e vogël për të sistemuar projektin, kontratat. Do të mbarojë besoj i gjithë riparimi i rrugës nga Kashari në Durrës, në pikat kritike deri në fund të qershorit. Do punohet ditën dhe natën", siguroi Rama.

### Miratohet procedura e përzgjedhjes së projekteve

## Mbështetja për prodhuesit e energjisë nga dielli dhe era



Këshilli i Ministrave miraton masat mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burime rinovueshme të diellit dhe erës. Masat do të përfshijnë garantimin e një kontrate për blerjen e energjisë së prodhuar, ku qeveria do të garantojë diferencën mes cmimit për KWh në kontratë dhe cmimit të shitjes në treg. Kjo kontratë do të ketë një afat maksimal prej 15 vjetësh. Masat përfshijnë, gjithashtu, kalimin

në administrim të shoqërisë, pasuritë e paluajtshme që nevojiten për realizimin dhe shfrytëzimin e projektit për të gjithë kohëzgjatjen e tij. Shteti garanton, gjithashtu, lidhjen dhe aksesin për përdorim të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes

së energjisë së prodhuar. Përzgjedhja e projekteve që do të përfitojnë nga masat e mësipërme do të bëhet përmes një procesi konkurrues të shpallur nga Ministri i Infrastrukturrës dhe Energjisë. Konkursi do të mbështetet mbi të dhënat e

projektit, si kapaciteti i instaluar, lloji i teknologjisë, vendndodhja, etj. Dokumentet e procesit dhe përzgjedhja e projektit fitues do të kryhet nga një komision i posaçëm. Ndër kriteret bazë të aplikimit përfshihen: kapaciteti financiar i shoqërisë

apo bashkimit të shoqërive; eksperiencia e mëparshme në vepra të ngjashme; përvoja në fushën e energjisë së rinovueshme; kriteri i besueshmërisë; etj. Miratimi i projekteve të përzgjedhura nga komisioni dhe nënshkrimi i kontratave do të kryhet nga ministri.



# VIP

Suplement  
Pages

E mërkurë 13 Qershor 2016 GAZETA SHQIPTARE

## "BULEVARDI POLITIK"

- Dukesha Kate në park duket si një grua e zakonshme, luan me fëmijët
- Ambasadorët larg "telasheve", mbliidhen dhe bëjnë kokteile...
- Konkurs për cjapin më të bukur, kryebashkiaku Peçi anëtar jurie
- "Në djall vaftë Trump", aktori i famshëm sulmon sërish presidentin

Një foto sa 1000 fjalë,  
këngëtarja na përçon  
dashuri nga larg



Jon Gjebrea thotë:  
"Të dua", por nuk i  
drejtohet të fejuarës



Rrëfehet ish-banorja e "Big Brother 9": Ja propozimi më pikant që më ka bërë një mashkull



Pjesë e një videoklipi apo një filmi, flet  
Dona Pjetri: Së shpejti prisni surpriza



*"Jam tipi që gjithmonë dua të testoj limitet"*

Rrëfëhet ish-banorja e "Big Brother 9": Ja propozimi më pikant që më ka bërë një mashkull

# Pjesë e një videoklipi apo një filmi, flet Dona Pjetri: Së shpejti prisni surpriza

*"Jam tipi që gjithmonë dua të testoj limitet"*

**N**uk kanë se si të mos mbeten protagonist të fokusit të medias rozë ish-banorët e shtëpisë më të famshme në Shqipëri. I rikthemi sërish atyre që u dhanë emocione dhe kaluan një eksperiencë të paharruar nën fokusin e kamerave 24 orë në 24. Por njëherë që mësohen me famën dhe suksesin që ajo u jep, nuk kanë se si të qëndrojnë larg saj. Kësaj radhe në një intervistë ekskluzive për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare" vjen Dona Pjetri, vajza nga Shkodra, e cila ishte çift me Musën në "Big Brother 9". Që nga ajo kohë e deri më sot shumë gjëra kanë ndryshuar. Dona na rrëfen se si së shpejti do të jetë pjesë e një videoklipi që do të jetë hit i kësaj vere si edhe eksperiencë e veçantë si aktore në një film shqiptar që do të dalë së shpejti. Por më pikantja e intervistës është propozimi i papritur që i është bërë Donës nga një mashkull. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.



Pamela Aliaj

**Tashmë larg kamerave të 'BB', por jeni sërish pjesë e një projekti të rëndësishëm. Për çfarë bëhet fjalë?**

Bëhet fjalë për një videoklip me artistin e ri Stefanarena i cili është dhe shoku im i ngushtë. Videoklipi përmban një tematikë aktuale në Shqipëri që do të zbulohet pas publikimit të tij.

**Si u bëtë pjesë e tij dhe çfarë roli keni? Kur do të kemi mundësi ta shohim këtë projekt dhe si nisi ideja që u bëtë pjesë e tij?**

Në klip kam rolin kryesor. Ndërkohë që gjatë xhirimeve më erdhi një ofertë për t'u bërë imazh i një brandi ndërkombëtar për intimo. Klipi publikohet më datë 20 qershor.


**Ju pëlqen të jeni pjesë e kinematografisë. Ju kanë propozuar të jeni pjesë e ndonjë filmi. Për çfarë bëhet fjalë?**

Me pëlqen shumë të jem pjesë e kinematografisë. Po, jam pjesë e një filmi shqiptar që pritet të dalë shumë shpejt. Sigurisht që do të më pëlqente shumë të merresha dhe një rol kryesor.

**Përveç impenjimeve, tashmë jemi në sezon verë. Ku do t'i kalojë Dona pushimet?**

Pasi të mbaroj impenjimet e mia po mendoj për pushimet për një kohë të gjatë. Me siguri do të jenë jashtë Shqipërisë, ndërsa disa ditë mund t'i kaloj edhe në jug të vendit. Me pak fjalë do jem në lëvizje me pushime.

**Ende single apo është dikush në jetën tuaj?**



Jeta ime më pëlqen që të mbetet private.

**Pavarësisht gjeneve, cili është sekretet i trupit tuaj kaq në formë?**

S'kam asnjë sekret për trupin. Ha çdo gjë dhe s'kam mbajtur asnjëherë dietë. Gjithashtu, merrem edhe me palestër, por jo rregullisht.

**Përveç modelingut, cili është pasioni tjetër i Donës që ne nuk e njohim?**

Përveç modelingut kam pasion aktrimin, ndërkohë që kam mbaruar shkollën e arteve për pikturë.

**Nëse do të propozonin të ishe pjesë e 'Big Brother Vip' a do të pranoni sërish? Pse?**

'Big Brother' 9 ishte një eksperiencë nga ku mora atë çka kërko-

ja. Unë gjithmonë synoj eksperiencë të reja, sfida të reja, projekte që mbase dhe nuk e kam parë veten të jem pjesë e tyre, por që gjithmonë kam qenë tipi që dua të testoj limitet.

Cili ka qenë propozimi më pikant që keni marrë nga një mashkull për t'u njohur? Si keni reaguar? Propozimi më pikant ka qenë që dikush më propozoi të bënim fëmijë që në fillimet e njohjes.



## NJË FOTO SA 1000 FJALË, KËNGËTARJA NA PËRÇON DASHURI NGA LARG

Tashmë kanë nisur pushimet për këngëtarën e njohur Jonida Maliqi. Ajo ka preferuar të zgjedhë Turqinë për të kaluar momente relaksimi me familjen e saj. Por kjo s'do të thotë se ajo po bën pushime edhe nga rrjetet sociale. Vetëm pak më parë ajo ka postuar dy video shumë të ëmbla ku vogëlushi i saj Dan, i shfaq dashurinë duke e përqaftuar para kamerës. "Ti je jeta ime", i thotë Dani. E ku ka dashuri më të madhe mes nënës dhe fëmijës!



## SA SHPEJT U RRIET! VOGËLUSHJA E AMIT DHE ERMALIT MBUSH 3 MUAJSHE

Ditëlindjet mbase nuk i mbajmë mend, por janë gjithnjë Vip-at tanë që na i kujtojnë, dhe jo vetëm të tyre, por edhe të fëmijëve. Duket sikur lindi dje, por mesa duket koha ka fluturuar edhe për vogëlushen e Amit dhe Ermalit. Tashmë engjëlli i vogël Sia mbushi 3 muajshë! Sa shpejt kaloi koha. Vetëm pak më parë në 'Instastory' ishte pikërisht Ami që postoi foton me tortën e saj të ëmbël rozë. Por siç ndodhi edhe me Joenin, prindërit kanë vendosur t'ia mbajnë të fshehtë fytyrën vogëluses. Mbase kur të rritet edhe pak do të mund të shohim edhe më qartë se kujt i ngjan Sia.



## JON GJEBREA THOTË: "TË DUA", POR NUK I DREJTOHET TË FEJUARËS

Ai është shumë i lidhur me motrën e tij, dhe pse shpesh herë është larg saj, nuk harron t'ia shprehë dashurinë edhe nëpërmjet rrjeteve sociale. Ana Gjebrea është bërë tashmë një zonjushë e vërtetë dhe Joni, i vëllai nuk harron të postojë në 'Instastory' foto të saj duke i bërë edhe dedikime të ndryshme tepër të ëmbla. "Të dua", shkruan Joni në një nga fotot ku Ana ka dalë me rrobëbanjo rozë ku duket si një ëmbël-sirë e vërtetë. Ndërkohë që në një tjetër ka postuar disa emoji të trishtuara. Duket se Jonin e ka marrë shumë malli për Anën e tij.



## ZGJIMI MË I BUKUR, MODELJA SHFAQ VIDEON MË TË ËMBËL

Ajo ka preferuar që gjithmonë që jetën e saj ta ndajë me ndjekësit e saj në 'Instagram'. Qofshin këto net pa gjumë apo ankesa të një nëne të re, Emina Cunmulaj është modelja shqiptare me famë botërore, e cila nuk heziton të jetë e pranishme pothuajse çdo orë të ditës në 'Instagram'. Sa e vështirë, por edhe sfidë është të jesh nënë e dy vogëluseshe, një 3-vjeçare dhe një të sapolindur. Pavarësisht gjithë problemeve dhe netëve pa gjumë, ajo ndan me ndjekësit edhe momente që janë sa 1000 fjalë. S'ka zgjim më të bukur për vogëlushen Mia Soraya sesa zëri i nënës. Videoja ku Emina shfaq vogëlushen tek sa e zgjon nga gjumi është një ndër videot më të ëmbla të saj. Sa e vështirë, por e shenjtë është të sjellësh një engjëll në jetë dhe të bëhesh nënë!



# BULEVARDI

## POLITIK

*Na merrni seriozisht!*

### Dukesha Kate në park duket si një grua e zakonshme, luan me fëmijët

**E**dhe fëmijët e familjeve mbretërore në fund të fundin janë si të gjithë bashkëmoshtarët e tyre. Edhe ata mund të ecin me këmbët zbatuar në bar. Një gjë të tillë e ka bërë edhe princesha e vogël Charlotte, e cila ka kaluar një ditë një ditë në park si të gjithë fëmijët e tjerë. Dukesha Kate dhe familja e saj janë fotografuar në një park, 2 orë e gjysmë larg Londrës. Dukesha e Cambrixhit dhe fëmijët e saj, Princi George dhe Princesha Charlotte udhëtuan larg Londrës. Dukesha dukej e relaksuar e ulur në park, si të gjithë njerëzit e tjerë. Ajo kishte zgjedhur një fustan bojë qielli me vija dhe ishte gjatë gjithë kohës e kujdesshme për fëmijët.



### Konkurs për cjapin më të bukur, kryebashkiaku Peçi anëtar jurie

**N**ë fshatin Nivicë të Tepelenës për herë të parë u mbajt një konkurs i ri në "PAN-FEST Nivica". Bëhet fjalë për organizimin e një konkursi për cjapin më të bukur të krahinës. Festa do të realizohet çdo vit, duke u shndërruar në një traditë për banorët e asaj zone. Sakaq, në konkurs mori pjesë edhe kryetari i Bashkisë së Tepelenës, Tërmet Peçi, i cili ishte dhe anëtar jurie. Fotot nga aktiviteti janë publikuar nga kryetari i Këshillit Shkencor në UNESCO, Auron Tare, i cili shprehet se ky konkurs është një përpjekje për të promovuar dhe ruajtur traditat e kësaj krahine.



### Ambasadorët larg "telasheve", mbledhen dhe bëjnë kokteile...

**D**uke bërë kokteile të ndryshme me përparëse veshur. Ambasadori i Shqipërisë në Maqedoni, Fatos Reka ka publikuar në "Twitter" disa foto gjatë një eventit të organizuar në një prej hoteleve më luksoze të Maqedonisë. Ambasadori shqiptar, ai suedez, italian, rumun e kinez kanë kaluar një të diel argëtuese në hotelin në Shkup të shndërruar në "kokteil ambasadorësh". Një shfaqje ndryshe kjo, larg "telasheve" politike e diplomatike.



### "Në djall vafte Trump", aktori i famshëm sulmon sërish presidentin

**A**i kurrë nuk ka qenë i butë me Donald Trump, aq shumë saqë e ka ftuar në mënyrë të përsëritur që të qëndrojë larg restoranteve të tij. Robert De Niro është kthyer për të sulmuar presidentin e Shteteve të Bashkuara me një tjetër "fuck Trump". Në çmimet "Tony", "Oscar"-i i teatrit që festohet në Nju Jork, përpara se të shpallte performancën e Bruce Springsteen, filloi fyerjen, me shumë mburrje të audiencës në sallë. Megjithatë, kalimi u censuroi në TV. De Niro përdori atë që mediat amerikane e quajnë "bombë F": "Dua të them diçka, fuck Trump", tha aktori. Dhe kur audiencia iu përgjigj me entuziazëm, ai përsëriti, duke thënë se "Trump nuk është më poshtë, është fuck Trump".



# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



## REPORTAZH

# Çamados, Kondurioti, Miauli, Kriezi dhe arvanitët heroikë të Greqisë

Nga Luan Rama

Kur shfletojta librin e piktorit Louis Duprë mbi udhëtimin e tij nëpër Shqipëri, Greqi e deri në Stamboll, mbi takimin me Ali Pashën, suljotët që kishin mbetur në Korfuz nga "Regjimenti i Shqiptarëve", veç shumë figurave të mrekulluara, pikturuar me një mjeshtri të veçantë ishte dhe një figurë simpatike, veshur në blu, që qëndronte buzë detit, në bregun e qytetit. Një portret i bukur, që shpesh kisha menduar se ishte figura e një greku, por kisha gabuar. Ishte një arvanitas i Hidrës, i familjes së famshme Çamados që aq shumë i kishte dhënë revolucionit grek për pavarësi. Në një shënim të vogël, në fund të faqes, Duprë kishte shkruar se ai ishte biri i Anastas Çamados. Duhet thënë se hidriotët dhe spociotët, ishin banorët arvanitas që në shekullin e XV siç dokumentohet dhe nga historianët grekë, arvanitas që kishin populluar këto ishuj të shkretë e gjithë shkëmbin, për t'u fshehur nga ndëshkimet turke apo dhe të Ali Pashës, qoftë ata që kishin ardhur nga Epiri e Çamëria, si dhe nga Eubea, apo Evia siç quhet sot. E vetmja mënyrë e ekzistencës së tyre ishte t'i drejtoheshin detit dhe të përballeshin me furtunat detare, të bëheshin marinarë të shkëlqyer dhe të ngrinin një nga flotat tregtare që do të spikaste në Mesdhe dhe që i çonte anijet e saj deri në portet e Atlantikut apo në Detin e Zi. Pikërisht atëherë u ngritën ndërtesat e tyre të mëdha të stilit venecian dhe ata nuk veshën fustanellat e arvanitasve të tjerë, por u veshën me rroba qytetare dhe mëndafshe nga më të bukurat e botës. Ja pse kjo veshje më kishte gabuar kur kisha parë atë portret hidrioti në akuarelin e piktorit francez Louis Duprë.

Familja Çamados, siç shkruajnë historianët grekë, vinte nga Epiri, Çamëria, çka spikat që në emrin e kësaj familje: Çamado-Çamados-Çami. Ai djalosh, që pozonte para piktorit francez, në vitin 1819, nuk e dinte se gjashtë vjet më vonë, në betejën e famshme të Navarinut me flotën turko-egjiptiane, babai i tij, heroi i revolucionit grek dhe admiralit Anastas Çamados, do të vritej heroikisht siç shkruhet dhe në librin "Historia e Greqisë nga viti 1892 deri në vitin 1844", nga Antoine de baron Juchereau de Saint Denys, Çamados kishte rënë bashkë me nën-admiralin e tij, heroin tjetër të revolucionit, Shahini, një tjetër çam i ardhur nga Epiri. Piktura e Duprë-së, në një format 40x50cm, na paraqet një djalosh të paqhtë, të bukur, me një vështrim ëndërrues buzë detit, në një kohë kur ende s'kishte filluar lufta për pavarësinë, por dhe ai, do t'i përgjigje zërit të luftës për çlirimin e Greqisë.



Anastasio Tsamalis



Admiral Emmanouil Tombazis (1784 - 1831). Oil-painting. Emanuel Tombazi

## Një udhëtim në Hidra mes shqiptarëve që lanë gjurmë

qisë.

Shumë udhëtarë perëndimorë kaluan nga Hidra e Specaj në shekullin e XVIII e XIX, historianë, gjeografë, arkeologë, shkrimtarë e piktorë, të cilët na lanë mjaft vepra të botuara, apo tablo që u shfaqën në ekspozitat e metropoleve europiane. Veç tablove të piktorëve grekë për figurat arvanitase, edhe piktorit francez Curzon na ka lënë një adolehent hidriot mjaft simpatik, e po kështu dhe portretet e famshme që ka realizuar në Specaj piktori Adam Friedel, veçanërisht e portretin e Bubulinës apo heronjve të tjerë të revolucionit të këtij qyteti. Ja pse Bubulina shkëlqen me ato kostume të mrekullueshme, aq sa duket e idealizuar nga skocezi Friedel. Kostume të veçanta, rite shqiptare, gjuhë shqipe, madje dhe kulti i gjakut, hakmarrjes kur familja ç'nderohet... Ja pse u vra dhe Bubulina, gjatë asaj hakmarrjeje kur djali i saj rrimbeu një vajzë arvanitase të Specaj, fqinjëve të tyre.


\*\*\*

Udhëtimi im i parë në Hidra apo Hidra siç shqiptohet në greqisht, ka qenë i paharruar, pasi gjithçka ishte poetike: deti i kaltër, qielli i pastër, një flad që frynte në anije dhe shfaqja e magjishme e atij ishulli të vogël ku disa kulla të larta ngjiteshin ende drejt majës së malit. Ishte Hidra për të cilën kisha dëgjuar shumë. Hidra e bardhë... Gurë, deti i kaltër e i pafund, diell, histori dhe arvanitas. Hidra e bukur dhe avangarda e Revolucionit grek. Hidra, "Flota e Lirisë", atdhe i Konduriotit,

Miaulit, Tombazëve dhe e admiralëve Kriezi, djepi që përkundi fëmijërinë dhe rininë e Bubulinës. Hidra e poetit të famshëm të shekullit XIX Jean Moreas, apo Jani nga Morea (Papadiamanti) që dhe nga nëna e i ati, siç shkruante për të poeti i famshëm francez Guillaume Apollinaire, ai ishte arvanitas që në fundin e shekullit XIX krijonte në Francë shkollën artistike të Simbolizmit francez. Përshëndesja njerëz, takoja grekë, arvanitas, shqiptarë, kapërceja shkallë të gurta dhe në çdo pëllëmbë është e pamundur të mos pikëta kjoje historinë me germë të madhe, "H", pasi ngado ishin gjurmët e një kohe të lavdishme.

Ishin ndërtesa të rënda të arkondëve të mëdhenj arvanitas

që në rast lufte mund të ktheheshin dhe në fortesa mbrojtëse, shtëpi të thjeshta popullore zbukuruar me lule, kafenetë në breg, pijetore dhe njerëz të rrahur nga deti si detarë të sprovuar që ishin të tillë historikisht në të gjithë Greqinë e Mesdheun. Hidra, vend i poetëve e artistëve, ku në një nga shtëpitë e Tombazëve sot është ngritur shkolla e Arteve të Bukura dhe ku një ditë erdhi dhe Marc Chagall. Në një ndërtesë tjetër vinte të banonte këtu Leonard Cohen (dhe më pas i biri, Adam Cohen gjithashtu që regjistroi dhe një disk të famshëm), apo ku vinte dikur Sofia Loren të luante në filmin "Hijet e detit" ... Ja, atje në sheshin e manastirit "Kimisis Teotoki", ajo kalonte duke lënë pas imazhin e vetë bukurisë ideale. Sot, as Cohen dhe as Loren nuk janë më aty... Në kafenenë buzë bregut dëgjojmë veçse këngën e Cohen.



Urna me zemrën e Miaulis

\*\*\*

Në vitin 2004, ishte hera e tretë që shkëlqej në Hidra, në qytetën e atij ishulli të përmbytur nga dielli ku nuk kishte makina, por veç gomerë për të udhëtuar. Ngjisja rrugicat e ngushta që më kujtonin Beratin e Gjirokastrën, kaloja krah shtëpish dhe pjesja veten se ku mund të ishte shtëpia e dikurshme e Bubulinës (Laskarinës), para se vazjë e re, ajo të shkonte nuse në ishullin fqinj Specia, nga ku s'do të kthehej më. Gjithë rinia e saj kaloi në atë liman, ku vajzat prisnin të vinin djemtë hidriotë nga peshkimi apo luftërat e gjata, nga anijet që nganjëherë për të bërë tregti, merrnin udhën deri në Argentinë, siç e përshkruan dhe historiani e shkrimtari francez Michel de Grece, në librin "Bouboulina", të cilin e përktheva me aq dashuri. Ishte ai libër që më solli në Hidra për herë të parë në vitin 1996, ndërsa tani ishte vetë historia. Në çdo vend që shkoje, dikush mund të të fliste për shkrimtarin e poetin anglez Lawrence Durrell që vinte këtu; për mikun e tij Henry Miller e shumë të tjerë, si dhe për mikun tim Lacarriere, i cili Hidrën nuk e ndante nga goja kur bisedonim për Greqinë. Po të ecje më tutje në këmbë, të ngjiteshe sipër shpatit që binte thikë mbi det, do të gjeje lagjen e peshkatarëve apo atë që quhet "Kamino", ku në terracën e një restorant të vogël popullor, mund të shijojë bukurinë e botës, duke pirë një uzo me "sardelica". Më tutje, në Mandraki, në kthinat e ishullit, ishin ende gjurmët e kantierit të vjetër detar, kur në shekullin XVIII-XIX ndërtoheshin anijet e mëdha të tregtisë e të luftës. Vetëm në kohën e Revolucionit, Hidra numëronte 125 anije dhe dhjetë mijë marinarë të saj...

Sot, sa zbrat në portin e vogël të Hidrës, në të majtë, ngrihet ndërtesa e muzeut, një nga ndërtesat që Konduriotët ia falën qytetit. Që andej i dallon akoma më mirë shtëpitë hijerënda të luftëtarëve të mëdhenj me ato mure të lartë si të Konduriotëve, Miaulëve, Tombazëve... Por kur hyn në sallonet e muzeut, hyn vërtetë në histori, se aty janë portretet e arvanitasve të mëdhenj që i dhanë fitoren revolucionit grek dhe që aq shumë luftuan për lirinë. Ja portretet e admiralit Anastas Kriezi (Kryeziu), një nga detarët e lavdishëm që shkoi deri në portin e Aleksandrisë të digte armatën e vezirit të Egjiptit. Në kohën e mbretit gjerman Oton të vendosur nga Fuqitë e Mëdha, ai ishte ministër i Marinës dhe më pas kryeministër, ashtu siç kishte qenë dhe Dhimitër Voulgaris, dikur guvernatori i qytetit e më pas tri herë kryeministër i Greqisë së re. Pak hapa më tutje, ja dhe portreti në ngjyra i Jorgo Konduriotis, i cili i dha Revolucionit dy milionë franga ari; më



Hydra

tutje portretet e dy admiralëve të famshëm Tombazi, Emanuel dhe Jacob Tombazi, njëri prej tyre gjyshi i poetit Jean Moreas. Krahu dhe një violinë "Stradivarius" e kësaj familje që ruhet ende në muze. Por ajo çka ishte më interesante ishin dy portretet e familjes Kriezi: Eleni Kriezi dhe Epaminonda Kriezi si dhe e admiralit Anastas Camidos (Çami) që të tre camë ortodoksë të ikur nga Çamëria dhe të vendosur në Hydra. Eleni mbante atëherë paratë e Revolucionit, ashtu si dhe Maria, nëna e Anastas Camidhes. Anastasi, ishte kapiteni i anijes së famshme "Nereus", me 16 topa, që në betejën e ishullit Sfakteries më 1825 kundër anijeve egjiptiane të Ibrahim Pashës, ra heroikisht dhe hyri në legendë, duke luftuar si dhe miku i tij Kanaris. Bashkë me Anastasin kishte rënë dhe kapiteni tjetër Stavro Shahini, një tjetër arvanitas i famshëm, fotografia e të cilit ndodhet gjithashtu në muze...



son, autori i librit *Tablo e Greqisë në vitin 1825*, kishte përshkruar mbresat e tij kur kishte zbkruar në Hydra, duke kujtuar takimet me banorët dhe njerëzit e shquar të këtij ishulli heroik. "Ndryshe nga pjesa tjetër e Greqisë, fytyrat e grave këtu janë më të bukura, por shamia që hedhin në kokë dhe e lidhin poshtë mjekrës ua mbulon disi këtë bukuri...". Ai shkon të takojë një nga drejtuesit apo primatët apo prijësit më të rinj të ishullit, Gjika Gjuni (ndoshta Gjoni, L.R.). "Takimet e shpeshta me evropianët e kanë bërë këtë njeri me mjaft kortezi e mirësjellje. Ai ka principe të shkëlqyera dhe një gjykim të shëndoshë, çka e kanë bërë një nga njerëzit më interesantë të ishullit... ai na flet për bursat për fëmijët që ata të shkojnë në shkollë dhe të mësojnë greqishten, pasi gjuha e vendit këtu është shqipja...". Një ditë më pas ata vizitojnë në shtëpinë e tij të famshëm Kriezi, një nga drejtuesit e vjetër të ishullit. "Ai është pothuaj tek të tetëdhjetat dhe gjyshi i tij ka qenë ndër kolonët e hershëm të

Hidrës, pra ka shumë eksperiencë dhe di shumë nga historia. Ka shtatë djem, të cilët që të gjithë i ka në flotën detare që lufton kundër flotës turke. Por ai është krenar veçanërisht me më të voglin, Anastasin, i cili drejton një nga anijet e atit të tij dhe që shquhet për trimëri të madhe"...

Kur del nga muzeu dhe hedh vështrimin nga deti e kupton se ky ishull jetonte dikur përmes heroikës së njerëzve të mëdhenj. Duke zbritur shkallët, ja dhe një shqiptar nga Berati që të thotë me krenari se gjatë dhjetë vjetëve aty janë vendosur 70 familje shqiptare të ardhura së fundmi, pas vitit 1990. Dhe ai, më shumë se kushdo nga ne shqiptarët, e ndjen sesa e rëndë është pesha e kufijve. Ishim në pragun e shtëpisë së dikurshme të Konduriotit, ndërkohë që përballë, njëqind metra më tutje, shikonim ndërtesën tjetër të Konduriotëve, akoma më madhështore.

Sigurisht, familja e Konduriotit ishte nga më të njohurat dhe nga më të vjetrat e ishullit. Historiani ynë i njohur Kristo Frashëri, duke iu referuar studimeve të Nik Haliorit të botuar në revistën "Tomellon" 1935, nr. 9, f. 225, shkruante ndër të tjera se në një nga shkrimet e tij kujtohej se "Kundurioti fliste me kënaqësi të madhe gjuhën shqipe me ishullorët dhe se admiralit, kur shkonte në Hidhra, përshëndeste përzemërisht në të folmen arvanite gjithë peshkatarët e ishullit". Po në këtë botim grek, shkruhet: "Prifti hidhriot Athanas Kuluras 93-vjeçar, në gusht 2005 i tregoi T. Johallasit këtë dëshmi të shkurtër: Kur prifti ishte 18 vjeç (duhet të ketë qenë viti 1930 -K.F.) një hidhriot i tha të çonte në shtëpinë e Pavlo Kunduriotit një kornizë të re me fotografinë e Andrea Miaulit. Mbas iu përshëndetën, admiralit e pyeti djalosin Kulura nëse dinte arvanitisht. - Jo, u përgjigj Kulura. - E atëherë, çfarë hidhrioti je ti që nuk di arvanitisht? Ju të rinjtë nuk duhet ta përbuzni, - e qortoi gjenerali. Unë, - vazhdoi gjenerali, - edhe në kohën e luftës e të përleshjeve me kundërshtarët, me luftëtarët e mi flisja vetëm arvanitisht dhe i frymëzoja ata...". Po kështu, Frashëri na sjell dhe dëshminë e studjuesit arvanitas Johallas mbi gjuhën arvanitase, ku arvanitët e ishullit flisnin gjuhën shqipe: "Këtë që të jap kartënë s'këjëm kështu hri t'e tërkönim (= dërgonim), se nëve ja u shkruajmë më gjithë ndë kartë, po për ngarkogh agh i ziv (i ziu është për këtim shqip i Mavro Kordhatos - Mavro = i ziu - K.F.), e dogh edhe Lurjoti, se u s'e doghë, se i njoha lojtotati. U njoh këtu me të vghanë e atit Tëlit, që isht i vghag martuarë ndë Maltë e u bë tu dhjavtlu. Mos jipni vesh ndë kartë sistatiki që i kemi dhënë; ao që thotë kartë jonë i dhiqisist se ma shërbëv di muagh pa mistlro, ashtu dogh ashtu e bëm për t'e nxërim ka vëthea. Një milë e pesëqint dumë na kostisi, rroba, kapelo, mamuze, këmishë, tirqi, vivlio, që dogh ato bën, njeri i patu(r)shëm. Nëve trembeshim t'i flasim ndënjë tetjo vent, mos vegh e thegh ki, e na havavegh shërbësi. Ruhuni ka lojtotiatit; amân ka kigh njeri, amân; i lig njeri. Të thâshë një milë e pesëqint e pesëqint dumë se na kostisi, maedhe di milë. Komitatoa ma tha të bënim një ekthes për të shih pramët e Eladhësë; e dham t'e shkruan; e bëri. Pastagh nëkë



mbet tropo të na e jip; u fandás t'e tipós vetë, e mûar bâshkë; kâqë edhe më shumë".

Pikërisht në Hydra, Specaj e Poros kishte jetuar për shumë vite studjuesi Carl Reinhold, i cili shërbente si mjek pranë marinës greke pas revolucionit. Por folklori i arvanitasve për të u kthye në një pasion të veçantë, duke mbledhur këngë popullore, përralla, fjalë të urta e legjenda, të cilat ndryshonin nga ato të grekëve. Madje ai i shkruante në një alfabet të çuditshëm ku në alfabetin me shkronja latine ndërhyjnë aty-këtu dhe shkronjat greke, apo germa të krijuara nga vetë ai. Ishin këngë dashurie, djepli, këngë humoristike që këndohehin në raste festash familjare apo qytetare.

"Mirë mbrömë, kunduriotë, Ishte vent të flëmë sonte?" - Ishtë, po s'guçon nga mëma, - Se më nxe e vlen nga mbröma...". Dorëshkrimin e tij, me një pjesë të folklorit arvanitas, Reinhold e botoi në Athinë në vitin 1855 nën titullin *Netë pellazgjike (Noctes Pelasgicæ)*,<sup>3</sup> çka është dhe e para përmbledhje mbi këngët dhe folklorin shqiptar në Greqi. Një pjesë e botoi albanologu gjerman Gustav Mayer, por pjesë të tjera të dorëshkrimeve të tij humbën në mugetirën e kohërave.

"More re të zeza, Çë më sjell kazozezë, Mos më sjell burrenë Çë kam dëshiruarë..."

Vallë ishin këngët e trishta të dramave dhe tragjedi të hidriotëve në vitet e luftës e të mbijetesës? Por një nga këngët më të bukura, ai e gjeti në gratë e ishullit fujnj Specaj, këngë që e kemi dëgjuar dhe në repertorin e këngëve popullore të Tefta Tashkos, pa e ditur se kjo këngë e vjetër na vinte nga arvanitasit e ishujve të Greqisë:

"Kur më vien burri nga stani puf, puf, puf më bön fustani, kur më vien burri nga klisha puf, puf, puf më bön këmisha, kur më vien burri nga ndara, dal e e pres me gas përpara..."

Në mbrëmje, lemë ishullit për të

shkuar në bregun tjetër përballë, në Porto Xeli. Vështroja Hidrën me ëndje (Sidra, siç quhej në kohët e vjetra) e cila më largohej me të njëjtën pamje krenare. Dhe kështu mendoja atë kohë kur arvanitasit e parë në vitin 1460 kishin zbkruar këtu në shkëmbinjtë e pabuar në kohën kur bashkë me venecianët, shqiptarët luftonin kundër anijeve turke që donin të pushtonin ishujt e Greqisë... Aty kishte hedhur rrenjë një jetë shqiptare, e mbrujtur në gjuhë arvanite si dhe zakone e këngë që nuk janë shuar dhe në një lidhje të fortë greko-shqiptare... Mu kujtua Hydra e dashur, vendlindja e Jean Moreas' të cilit i kisha kushtuar një libër, si dhe legjenda për të cilën shkruante Apollinaire "se një ditë, pas vdekjes, Jean Moreas hipur majo një kali, çante më detit për të shkuar në vendlindjen e tij..."

Pra, tre vjet pas vdekjes së Moréas-it, Apollinaire do të pyste në shtypin e kohës se "ç'bëhet rreth përmendores që do të ngrihej për Moréas-in në Paris". Ndër të tjera ai shkruante: "Sot në Amerikë ka një legjendë të Moréas-in. Këtë legjendë të hatashme, ma tregoi Frederic Boutet. Legjenda ishte botuar me shumë detaje në një gazetë amerikane. Po t'i besosh kësaj legjende, thuhet se Jean Moréas kishte vendosur të shkronte për të takuar miqtë, duke u kërkuar fotografitë e tij, me qëllim për t'i zhdukur ato. Pastaj kishte bërë një kalë të bardhë, me të cilin shkoi gjer në Dieppe, ku deti nuk e ndalo, pasi ai shkoi drejt tij dhe hyri me kalë..."

Kjo legjendë nuk ishte thjesht një anekdotë. Së pari ajo tregonte se Moréas ishte bërë mjaft i njohur dhe në Kontinentin e Ri, në bregun tjetër të Atlantikut. Së dyti, imazhi i tij mbi kalë që humbiste drejt detit të pafund, tregonte për natyrën e vërtetë të Moréas-it, njeriut që kishte dhe jetonte si në legjenda, pasi padyshim, ashtu do të kishte ëndërruar të ishte nga kjo botë, hipur mbi një kalë të bardhë, drejt një deti të pafund, të cilin ajo shumë i kishte kënduar.



Opinion *i* Ditës

# Baba, mos vrit mamën, por mentalitetin dhe alkoolin!

Nga Enkel Xhangoli

(vijon nga faqja 1)

... mbi një femër, mbi një nënë a motër, kjo burracakëri deri në kufijtë e çmendurisë. Vetëm në gjysmën e këtij viti kemi 6 gra të vrara nga burrat e tyre, ku pothuajse të gjitha rastet janë të ngjashëm ose xhelozia e vazhdueshme, ose një konflikt i momentit që rezultojnë fatal.

Edhe pse jemi në vitin 2018, ku njerëzit duken më të emancipuar apo më mendjehapur, duket sikur kjo shoqëri po përpigjet të ndryshojë jetesën sociale jashtë, ndërsa brenda mureve të shtëpisë përplasemi përsëri me mentalitetin e shekujve të shkuar.

Brenda këtyre ne si shoqëri (jo të gjithë) jemi aq të prapambetur sa nuk mund të bëjmë dot ndarjen e një femre nga një mall, e një femre nga një pronë, pasi brenda atyre mureve na duket vetja zot të gjithçkaje.

Shprehjet “të rrah për të mirën tënde”, ose “kush të rreh të do”, për mendimin tim janë shprehjeje të vjetra të nxjerra nga një shoqëri e dhunës, të cilat nuk kanë vend në një shoqëri të cilën po përpigjemi të ndërtojmë prej gati 30 vitesh. Krimin në familje nuk mund të lindë vetëm nga mentaliteti apo prapambetja e një personi apo grupi të caktuar, ai mund të lindë edhe nga kushtet e këqija ekonomike apo problemet me alkoolin.


Shumë denoncime bëhen në polici nga gra, të cilat dhunohen nga burrat nën e efektin e alkoolit dhe shumë e shumë të tjera, të cilat zgjedhin të durojnë grushtet dhe shqelmat për të mos prishur apo për të mos lejuar paragjykimin e familjes në sy të të afërmeve apo dhe të komshinjve.

Kur një femër bën zgjedhjen e dytë, jeta e saj vihet në rrezik, madje deri në vdekje për të mbrojtur nderin e familjes, që është përdhunuar e nëpërkëmbur nga burri, i cili jo vetëm që harron vlerën e një gruaje, por harron rëndësinë e një familjeje dhe të fëmijëve të tij.

Sa e sa fëmijë janë bërë dëshmitarë të vrasjeve të nënave të tyre nga baballarët dhe shumë të tjerë durojnë dhunën fizike dhe psikologjike të një babai pjanec. Një baba, i cili urren veten duke shkatërruar të tjerë.

Çfarë shembulli mund të japë një baba i tillë një fëmijë? Si mund të presësh që ky fëmijë të shkillohet dhe formohet normalisht?

Britmat dhe lutjet e nënës së tij për mëshirën e babait jam i bindur që do ta shoqërojnë atë gjithë jetën, ashtu si jam i bindur që ky fëmijë nuk do e falë kurrë një baba të tillë. Një familje ku ndërthuret alkooli dhe xhelozia, rezultati është dhunë dhe në jo pak raste edhe vdekje.



Nëse do të hedhim sytë në instancat e ndryshkura shoqërore, do gjëmë me dhjetëra raste, të cilat gratë me urdhër mbrojtje janë dhunuar dhe vrarë sikur shteti të ishte inekzistent. A duhet të mbajë shteti përgjegjësi për këtë?

Sigurisht që po, por kush është dënuar deri më sot se një urdhër mbrojtje nuk ka funksionuar ashtu sipas parashikohet në ligj? Askush! Si

gjithmonë haraçin dhe kërbacin e mbajnë gratë, nënat apo motrat, pasi burrat “kuvendojnë” me telekomandën e televizorit në dorë dhe shishen e rakisë në dorën tjetër brenda mureve të shtëpisë së tyre.

Sigurisht që raste të tilla provokohen ose shiten dhe si shembuj të gatshëm edhe nga vetë mediat, pasi në vend që t'i kushtohet hapësirë apelit kundër dhunës, i jepet

rëndësi se si ndodhi lajmi, madje duke e përcjellë viktimën deri në banesën e fundit. Kjo është përgjegjësi e medias, pasi me dashe apo pa dashe edhe ajo ka rolin e saj.

Mendoj që për aq kohë sa gruaje mendon se po u martua i për ketë burrit dhe do kemi neglizhencë për denoncimin e rasteve të dhunës, do vijojmë të numërojmë viktimat e krimit në familje. Dua që gratë të besojnë se ajo grua dhe burri i përkasin njëri-tjetrit dhe në momentin që ai zgjedh rrugën e “djallit”, ajo duhet të distancohet dhe t'i drejtohet drejtësisë pa u menduar dy herë.

Ndoshta kështu nuk do të kemi më fëmijë që bëhen dëshmitarë të vrasjeve të nënave, apo gjyshër që rrisin nipër jetimë, duke vajtuar fëmijën e tyre. Shpresoj dhe besoj se kjo shoqëri po ndryshon, por më parë duhet të ndryshojë brenda mureve të shtëpisë për ta përcjellë atë më pas edhe jashtë saj.

Shprehjet “të rrah për të mirën tënde”, ose “kush të rreh të do”, për mendimin tim janë shprehjeje të vjetra të nxjerra nga një shoqëri e dhunës, të cilat nuk kanë vend në një shoqëri të cilën po përpigjemi të ndërtojmë prej gati 30 vitesh. Krimin në familje nuk mund të lindë vetëm nga mentaliteti apo prapambetja e një personi apo grupi të caktuar, ai mund të lindë edhe nga kushtet e këqija ekonomike apo problemet me alkoolin.

## HOROSKOPI

### DASHI

Plutoni jo shumë miqësor do t'ju kujtojë se duhet të ndërtoni marrëdhënie të karakterizuara nga ekuilibri i duhur midis rastësisë dhe vetëkontrollit. Vazhdoni të hani në mënyrë të shëndetshme, duke zgjedhur me saktësi ushqime të cilësishë së mirë.

### DEMI

Hëna rrit optimizmin dhe aftësinë komunikuese. Vërtet do të jeni pak egocentrikë, por edhe të shkëlqyer dhe interesant si kurrë më parë. E dini fatin tuaj, por do të arrini edhe të përfitonin nga rasti për të mësuar nga persona vërtet të veçantë.

### BINJAKET

Do të keni fërkime me një familjar që këmbëngul që gjithçka shkon mirë, ndërsa në realitet ka tensione të fshehura. Kush jeton në çift, duhet të bëjë kujdes që të mos ndërlikojë atë që është e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë.

### GAFORJA

Me planetin e dashurisë që ju mbron, do të kërkonit mundësi dialogu dhe bashkëpunimi me personin e zemrës. Lidhja do të rezultojë më e forcur. Me Venusin që vazhdon t'ju mbrojt, nuk duhet të sforcoheni shumë për të qëndruar në formë.

### LUANI

Mirëkuptimi i personave që ju qëndrojnë në krah do ta ketë të vështirë të çajë nervozizmin tuaj. Do të jetë e vështirë të ruash qetësinë ndaj atyre që vazhdojnë të bëjnë po të njëjta propozime shumë e shumë herë.

### VIRGJERESHA

Me favorizimin e Jupiterit, nëse jeni në kërkim të një pune, dijeni se fati mund t'ju trokasë në dorë. Mos rriini duarkryq. Me Venusin mike që ju vëzhgon, mund të hapni një kapitull të ri në lidhjet tuaja dashurore.

### PESHORJA

Ndonjë zënkë më shumë dhe klima dashurore do të ndikohet ndjeshëm. Do të jetë më mirë t'i kontrolloni reagimet gjaknxehta. Një mik, vetëm për të mohuar mbështetjen e premtuar, do të përpigjet t'ju fusë dyshime për zgjedhjen e bërë.

### AKREPI

Venusi, Marsi dhe Neptuni bashkëprojnë me Hënë në favorin e juaj. Do të njihni persona të cilët mund t'ua vërtetojnë menjëherë vlerën dhe sinqeritetin. Po kaloni një periudhë ndryshimesh në çdo fushë. Të papriturat do t'ju bëjnë përsëri vizitë.

### SHIGJETARI

Do të kaloni disa zënka dhe do t'ia dilni të tejkaloni të gjitha pengesat që ju ndalojnë të merreni vesh me partnerin e dashur. Mos i lini pa dorë çështjet private për të dëgjuar dhe për të ndihmuar një person që ju kërkon ndihmë.

### BRICJAPI

Me Neptunin që ju mbron, mund të mbështeteni tek miqësi dhe kontakte konstruktive. Jini të sigurt, jeta e juaj është duke evoluar në drejtime më interesante. Me Marsin armiqësor, kini kujdes nga gabimet në vlerësimin e sjelljeve për të mos gabuar.

### UJORI

Do t'ju duhet të përballeni me ndonjë të papritur dhe nuk do të keni atë elasticitet që do të ishte i nevojshëm për t'u përballur me risi dhe për të riorganizuar programin. Kjo mënyrë e vazhdueshme për të pyetur të tërët ndoshta fsheh paafësinë për pranuar atë çka është e ndryshme nga ju.

### PESHQI

Në ndikimin e Uranit dhe Venusit nëse jeni beqarë perspektiva interesante risish në sektorin e dashurisë. Do të rrethoheni nga njerëz me të cilët njihni mirë dhe do të mënjanoni ata që duan t'ju detyrojnë zgjedhjet dhe mendimet e tyre.



**S**kënderbeu ka konfir muar dënimin 2-vjeçar për Jashanicën, teksa Komisioni i Apelit të UEFA-s ka vendosur të lërë në fuqi masën disiplinore kundër futbollistit të korçarëve. Njëpërmjet një reagimi për shtyp, Skënderbeu ka njoftuar se pavarësisht argumenteve dhe dëshmime të dhëna, nuk ka mundur të ulë dënimin për lojtarin e tij. Tashmë bëhet e ditur se drejt KAS-it po shkon një tjetër çështje e këtij klubi, por këtë herë flitet për fatin

### Mbrojtësi u pezullua 2 vjet për përdorim dopingu

## Apeli nuk i ul dënimin Jashanicës, Skënderbeu shkon në KAS

individual të një futbollisti. "Komisioni i Apelit i UEFA-s vendosi lënien në fuqi të masës disiplinore "pezullim nga aktiviteti" për një periudhë 2-vjeçare për lojtarin e KF "Skënderbeu", Bajram Jashanica. Pavarësisht argumenteve dhe dëshmime të

dhëna në seancë gjyqësore nga ana e lojtarit dhe personave të tjerë të lidhur me çështjen, organi juridik vendosi mospranimin e kërkesës të paraqitur nga Bajram Jashanica për uljen e sanksionit. Bëjmë me dije se aktualisht, palët janë në pritje për

disponimin nga ana e Komisionit të Apelit të UEFA-s të vendimit integral, i cili do të ankimohej në CAS. KF "Skënderbeu" i ka ofruar lojtarit të gjithë mbështetjen e mundshme gjatë kësaj periudhe të vështirë për të dhe beson se masa disiplinore

është disproporcionale me rrethanat e ngjarjes dhe me shkallën e përgjegjësisë të Bajram Jashanica. Për këtë arsye, në çdo formë dhe me të gjitha mjetet në dispozicion, do të kërkojmë vendosjen e një mase disiplinore më të ulët, për garantimin e vijueshmërisë së karrierës të lojtarit tonë", lexohet në komunikatën e klubit bardhekuq.



Jeton Selimi

Ndërkohë, drejtuesit e kuq janë takuar me serbin Milinkoviç, që duket më afër stollit se kurrë

# Batha: Largohehem nga Partizani, italianët prishën një ekip të fortë

Mesfushori shpreson në një eksperiencë jashtë vendit



bashku. Ne që quheshim "garda e vjetër", që nuk ekzistonte fare në ekip, ishte si një presion për ne, pasi na faturohej gjithçka. Ishte një term i gabuar "garda e vjetër", pasi ne të gjithë luftonim vetëm për një

qëllim, që të shkonte sa më lartë Partizani. Partizani më i fortë ishte me Ekubanin në sulm, me Torasën dhe Cetkoviçin. Nuk ka dyshim për asnjë tifoz, që ai ishte më i forti. Dëshirë kam që të provoj veten me një aventurë


jashtë vendit dhe shpresoj që t'ia arrij qëllimit, prandaj nuk po bisedoj me klubet në Shqipëri. Jam duke pritur disa mundësi që kam për jashtë dhe nëse kjo nuk reali-

zohet, atëherë do të shoh variantet në Shqipëri", ka thënë Batha për "Super-sport".

### Drejtuesit takohen me Milinkoviç

Partizani ende nuk ka një trajner në stol. Pavarësisht se Klevis Dalipi zyrtarisht nuk është shkarkuar nga stoli i kuq, drejtuesit e Partizanit kanë plane të tjera. Olsi Rama kërkon me çdo kusht që stolin ta marrë një trajner i huaj. Me pistën e Mario Tokiç të perënduar, në skenë ka dalë emri i Mladen Milinkoviç. Ish-trajneri i Luftëtarit dhe i Kukësit, është lakuar dhe më herët, ndërsa ditën e djeshme gjërat kanë marrë rrugë më serioze, pasi palët janë takuar dhe kanë biseduar mes tyre. Gjithsesi mbetet për t'u parë në do të jetë Milinkoviç apo jo trajneri i ri i Partizanit.

### LOJTARI I BELGJIKËS



### E quditshme, trajneri i Kosta Rikës nuk njeh Hazardin

Eden Hazard është një emër shumë i njohur në të gjithë botën dhe me siguri, çdo ndjekës i rregullt i futbollit po t'i tregosh foton e tij, e njëh me vëndndje. Thuajse të gjithë, pasi duket se trajneri i Kosta Rikës, një prej ekipeve pjesëmarrëse në Rusi 2018, nuk e njeh se kush është ylli i Belgjikës, të cilin e kishte kundërshtar një natë më parë në një miqësore. Hazard ishte i pakapshëm në këtë takim, me driblme, pasime e shumë manovra që ia bënë të thjeshtë punën sulmuesve të Belgjikës në suksesin 4-1. Pas ndeshjes, trajneri Oskar Ramirez, i çudit të gjithë me komentimin rreth paraqitjes së tij. "Ai lojtari me numrin 10 na shkaktoi shumë dëme, nuk e di se si e ka emrin", tha ai para gazetarëve në konferencë për shtyp, mes çudisë së përgjithshme se si ai nuk njihnte një nga yjet e futbollit në Europë, e për më shumë një lojtar të cilin e kishte rival e si rrjedhojë duhej të kishte informacione për të. "Si mund t'i mundim, kur ne nuk i njohim as lojtarët e kundërshtarëve. Si mund të ketë bërë trajneri fjalimin para lojtarëve të vet duke u ndarë detyrat kur nuk di se kë t'u thotë të mbajnë", ishin talljet në shtypin e vendlindjes së tij pas këtyre fjalëve.

### Perez vendos për timonierin e Spanjës

## Zyrtare, Lopetegui trajneri i ri i Realit

**K**a marrë fund dilema Realit të Madridit për të gjetur pasuesin e Zinedin Zidane's, i cili dha dorëheqjen pak ditë pas triumfit për herë të tretë radhazi në Champions League. Presidenti Florentino Perez ka arritur akordin me trajnerin e kombëtares spanjolle, Julen Lopetegui, i cili do të ulët në stolin madrilen menjëherë pas përfundimit të kampionatit botëror "Rusi 2018". 51-



vjeçari ka drejtuar të gjitha skuadrat e moshave të kombëtares spanjolle, ndërsa ka qenë trajner edhe i Real Madrid B, në sezonin 2008-

2009. Kulmi i karrierës së tij si trajner klubesh ishte drejtimi i Portos në sezonet 2014-2016, ndërsa më pas u ul në stolin e "Furia Roja"-s. Julen Lopetegui ka firmosur një kontratë 3-vjeçare me Realin e Madridit, duke pranuar të drejtojë skuadrën deri në vitin 2021. Më herët Perez pati kontaktuar edhe trajnerë si Conte, Allegri, Pochettino etj., të cilët refuzuan të ulen në stolin e kampionëve në fuqi të Europës.

### Adil Rami e goditi në kavigje

## Alarm te Franca, dëmtohet Kilian Mbape

**A**larm i kuq te Franca për Kilian Mbape. Vetëm pak ditë përpara debutimit në Botëror në ndeshjen ndaj Australisë, përfaqësuesja e 'gjelave' është në ankth për gjendjen e një prej talenteve më të mëdhenj që ka prodhuar futbollit francez në këto vitet e fundit. Mbape ka lënë përpara koha stërvitjen e kësaj të marte në vendngurrullimin e Francës në Glebovets, pasi ka marrë një goditje në kavigje. Sipas asaj që zbulojnë mediat ndërkombëtare sulmuesi i PSG

është goditur me forcë në kavigjen e këmbës së majtë nga mbrojtësi i Marsejës, Adil Rami, dhe është larguar mes dhimbjesh nga fusha stërvitore. Stafit mjekësor i një herë kampionëve të botës i ka ardhur menjëherë në ndihmë 19-vjeçarit, por ende nuk dihet shkalla e dëmtimit të Mbape. Në orët në vijim sulmuesi do t'u nënshtrohet të tjera analizave më të detajuara për të kuptuar shkallën e dëmtimit. Një lajm shumë i keq ky për trajnerin e Francës, Didier Deschamps vetëm 4 ditë përpara debutimit në Botëror.



[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

## Tashmë edhe lundroni!

